

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**T R A N S K R I P T I  
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË  
KOSOVËS TË MBAJTUR MË 30.3.2007**

**T R A N S K R I P T  
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE DANA 30.03.2007.GODINE**

---

***PRILL- APRIL 2007***

## **REND DITE**

- 1 Miratimi i rendit të ditës,
- 2 Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 14, 16 dhe 22 mars 2007,
- 3 Koha për pyetje parlamentare,
- 4 Interpelanca e ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, z. Haki Shatri, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar ORA,
- 5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
- 6 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bletarinë,
- 7 Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me Projektligjin për Ditën e Dëshmorëve,

## **DNEVNI RED**

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica, od 14, 16, i 22. marta 2007. godine,
3. Postavljanje parlamentarnih pitanja,
4. Interpelacija ministra za privredu i finansije gospodina Hakija Shatrija po zahtevu Parlamentarne grupe ORA,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti od buke,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o pčelarstvu,
7. Razmatranje Izveštaja Komisije za pravosuđe, zakonodastvo i Ustavni okvir o Nacrtu zakona o danu palih boraca.

## **Seancën e kryesoi anëtari i Kryesisë Xhavit Haliti**

**Seanca filloi me punë në orën 10,00**

**Në sallën e Kuvendit të Kosovës**

### KRYESUESI XHAVIT HALITI

Të nderuar deputetë, ministra, mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj që në sallë janë 72 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë.

Andaj propozoj të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Të gjithë e kemi marrë rendin e ditës dhe e kemi një kërkesë të deputetit Ramadan Kelmendi.

Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në ndërkohë në pajtim me rregullën 23.3 lidhur me rregullën 29 deputeti Ramadna Kelmendi është drejtuar me propozim që në rend dite, si çështje urgjente të përfshihet debati lidhur me ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në pjesën Veriore të Mitrovicës.

Andaj në pajtim me rregullën 29 lus Ramadan Kelmendin dhe pastaj kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen lidhur me propozimin në fjalë.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar të pranishëm.

Jam i vetëdijshëm se ka shumë çështje me rëndësi për Kuvendin e Kosovës, por një ndër çështjet me rëndësi jetike për 18.72% të territorit të Kosovës dhe për 23.882 qytetarë shqiptarë të lagjes Veriore të Mitrovicës, është pikë mjaft me rëndësi edhe vënia e urgjencës së ndalimit të ndërtimeve kolektive që bëhen në pjesën Veriore të qytetit të Mitrovicës nga Qeveria e Beogradit të cilat poqë se vazhdojnë me këtë temp do të shkaktojnë, jam thellësisht i bindur, jo vetëm pakënaqësi, por pasoja të rënda për politikën paqedashëse dhe shtetformuese të të gjithë neve dhe qytetarëve të Kosovës dhe do të na sjellin deri te të padëshiruarat e të paparashikuarat. Faktet janë të shumta:

1. Në lagjen Veriore të Mitrovicës që nga lagjja e doktorëve e deri në fund të lagjes së boshnjakëve, Qeveria e Serbisë, me financimin e vet, ndërton 4 ndërtesa kolektive për të vendosur ardhacakët dhe kriminelët kryesisht ata nga viset e ish- Jugosllavisë që tani janë formuar si shtete.
2. Qëllimi është i strategjisë hegjemoniste për të forcuar vijën ndarëse mbi bazën etnike, buzë rrjedhës së lumit Ibër.
3. Për të bërë presion të vazhdueshëm edhe mbi pak ata shqiptarë të mbetur atje për ta lëshuar atë pjesë, për t'i lëshuar shtëpitë dhe trojet e tyre shekullore.

KRYESUESEI XHAVIT HALITI – Z. Kelmendi, materialin e kanë marrë të gjithë nëpër posta dhe mendoj që e kanë të qartë qëllimin e propozimit tuaj, sipas Rregullores 2 minuta i keni kohë me propozue. Koha ju ka kaluar.

Për rend dite kemi ndonjë kërkesë tjetër.

DEPUTETJA TEUTA HADRI – Në këtë rend dite janë caktuar pikat, dihet rendi i ditës, mirëpo në bazë të këtyre pikave nuk ka ndonjë ngarkesë dhe kohë që do të humbet në këtë Parlament se pika e parë dhe e dyta janë miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara dhe pikat 5 dhe 6 janë shqyrtime të dyta të ligjeve . Mendoj se nuk do të humbim kohë, është shumë e arsyeshme dhe të gjithë deputetët do të pajtohen që ta fusim çështjen e shëndetësisë në Kosovë që është mjaft emergjente si pikë e rendit të ditës.

Zotërinj deputetë, z. kryesues, unë besoj se klinikat e Prishtinës kanë mbetur me maska që përdoren 1 herë ata i përdoren 10 herë, Besoj se është e vlefshme që sot të bisedohet në këtë Parlament për gjendjen e shëndetësisë kosovare, më shumë se shumë pika që sot janë në rend dite. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, ndonjë kërkesë tjetër, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

DEPUTETI LULZIM ZENELI – Faleminderit z. kryesues. Të nderuar deputetë.

Sot kur po e mbajmë këtë seancë plenare, në kohën kur forumet ndërkombëtare, Parlamenti i Kosovës, NATO-ja, Grupi i Kontaktit dhe vendet veç e veç diskutojnë propozimin e presidentit Ahtisari dhe mbështesin propozimin për pavarësi të Kosovës, sot Kuvendi i Kosovës me këtë rend të ditës krijon një përshtypje që manifeston ose një dozë të frikës tek opinioni ynë dhe të miqtë tanë ndërkombëtarë ose demonstrim i nivelit të jo përgjegjësisë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së propozoj që ky Kuvend sot në këtë seancë plenare me dalë me një qëndrim përmes një deklaratë që sublimon qëndrimin e Kuvendit të Kosovës karshi zhvillimeve politike që po e përcjellin Kosovën dhe procesin e pavarësisë së saj. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Fjalën e ka deputeti Alush Gashi .

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryesues.

Çështjet që u ngritën meritojnë një vëmendje të posaçme, por natyrisht kërkojmë që këto çështje të zgjidhen sipas procedurave apo sipas Rregullores së punës të Kuvendit. Është koha që njerëzit të mësohen si përgatitet rendi i ditës. Ne kemi pasur një seri të mbledhjeve të shëfave të grupeve parlamentare me Kryesinë e Kuvendit dhe jemi pajtuar për këtë rend të ditës. Çështjet e ngritura sot janë çështje të cilat kërkojnë procedura parlamentare. Çështja e ndërtimit legal apo ilegal është çështje e ndarjes së pushteteve. Është pushteti qendror dhe është pushteti lokal. Në kohën në mes të dy seancave **nuk** ka ndodhur fillimi i ndërtimit të objekteve kolektive në pjesën Veriore të Mitrovicës, andaj ne do ta mbështesim një raport i cili vjen nga niveli lokal në Mitrovicë, nga Kuvendi Komunal, nga administrata ndërkombëtare dhe nga Agjencioni Kosovar i Pronës dhe pas atij argumentimi ne me kënaqësi të posaçme do të marrim pjesë në debat.

Sa i përket iniciativës së shumpërsëritur për çështje të shëndetësisë, mendojmë se kur të bisedohet për shëndetësi nevojitet një përgatitje e mirëfilltë ,por në takimin e shefave të grupeve parlamentare me Kryesinë e Kuvendit kjo çështje as që është përmendur. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Gashi. Për fjalë është paraqitur z. Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryesues.

Vlerësoj të gjitha propozimet që u bënë këtu, por unë mendoj se një çështje e ngutshme që na ka dalë këto 2-3 ditë është çështja e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, ose dyfishimit të tarifave për konsumatorët e Kosovës. Unë mendoj se është koha që Kuvendi ta marrë seriozisht në shqyrtim çështjen e KEK-ut i cili po keqpërdor edhe pagesën e rrymës edhe pasuritë dhe buxhetin e Kosovës, s'ka 2-3 ditë që ju kanë ndarë 75 milion euro nga buxheti i Kosovës KEK-ut dhe këto para janë para të taksapaguesve, nuk janë as të **këshillit ekonomik** as të Qeverisë dhe me gjithë atë qytetari ynë vazhdon të mbetet pa rrymë dhe tash duhet të paguajë dyfishin e çmimit për energjinë që shpeshherë edhe nuk e konsumon dhe nuk e ka. Prandaj është mirë që t'i vihet pikë kësaj pune dhe këto grupe që quhen herë menaxhmentë, herë ministri, rregullatorë e ku ta di unë, për të mos me u thënë me ndonjë emër tjetër, duhet të merren në përgjegjësi dhe të shihet puna e tyre, sepse janë duke luajtur me një çështje shumë të ndjeshme, mëqë energjia nuk është thjesht një mall për konsumatorin, por është një çështje strategjike e Kosovës edhe politike, po na ve edhe Kosovën edhe qytetarin në një pozitë vërtet të rëndë dhe kanë cenuar rëndë me këtë rritje edhe stabilitetin social edhe ashtu të brishtë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Bislimi. Për fjalë është paraqitur deputetja Teuta Sahatqija

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA- Faleminderit z. kryesues.

Në fillim pas diskutimit të z. Ramadan Kelmendi, kërkuat deklarinimin e shefave të grupeve dhe pikërisht për këtë çështje desha të shpreh mendimin e grupit tim.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju lutem një moment. Më falni që nuk e sqarova unë. Unë thashë kush ka propozime lidhur me këtë, më duket që janë kryer propozimet, Alushit ia dhash fjalën, sepse mendova mos ka ndonjë propozim shtesë, e dha mendimin e vet, s'ka propozime të tjera, d.m.th. Ramadan Kelmendi është parqitur prapë. Nuk e di a ke me shtue diçka përveç asaj që kërkoje. Fjalën e ka z. Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit. I nderuari kryesues, ministra, të nderuar të pranishëm.

Sa i takon pikës së parë do të ishte mirë që të votohej se a do të hynte në rend dite apo jo. Nuk është kryer ajo procedurë, për atë e mbani përgjegjësinë ju.

Në emër të 6 deputetëve të Kuvendit të Kosovës ne kemi formuar Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë dhe i njëjti ka paraqitur shkresë në procedurë të paraparë me Rregulloren e punës së këtij Kuvendi. Ne nuk kemi marrë konfirmim, nuk

është njoftuar Kuvendi dhe lus t'i ushtroni përgjegjësitë, kryetari dhe Kryesia, ashtu siç është përcaktuar me Rregulloren e punës së Kuvendit, sepse edhe sot pika e parë që u shtrua me shkrim e argumentoi atë që ne si grup parlamentar apo unë si shef i këtij grupi parlamentar nuk kam marrë pjesë në atë takim ku është diskutuar rreth ndërtesave kolektive në Mitrovicë ,për të cilat i nderuari profesor Alush nuk ka informacione se çka ndodhur atje. Atje janë të përzier shqiptarët, janë të përzier Qeveria e Serbisë dhe atë nëse nuk e ndalim ,ne do ta humbim një pjesë shumë të madhe të Kosovës. Prandaj ju lus që Grupin Parlamentar të LDD-së ta funksionalizoni në raport dhe në harmoni me Rregulloren e punës së Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Më fal Teuta e keni fjalën.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Z. kryesues, a jemi duke biseduar, duke dhënë mendimin për këtë propozim apo jo?

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Deklarimi i kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimet që janë dhënë dhe unë po mendoj që t'i qes në votim një nga një propozimet, tjetër zgjidhje nuk ka.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Z. kryesues, të nderuar deputetë dhe ju ministra. Mendojmë që brenga të cilën z. Ramadan Kelmendi e ngriti është vërtet një breng e arsyeshme, e ligjshme dhe një kujdes për komunitetet të cilat jetojnë të rrethuara me një komunitet tjetër dhe vërtet pozita e komuniteteve, pa marrë parasysh të cilit etnitet, duhet të jetë një çështje prioritare dhe të kujdesemi që ata të mos pësojnë për shkak se janë pakicë të rrethuar me një shumicë tjetër, por mendojmë se kjo qasje në këtë mënyrë prej një anëtar i cili është anëtar i pozitës ,si në nivelin qendror, si në nivelin lokal dhe atë që 5 vite, mendoj që kjo qasje nuk është qasje e duhur, por një qasje demagogjike. Në Mitrovicën e Veriut isha në vizitë me një delegacion prej ORËS në Ditën e Mësuesit dhe e vizituam shkollën, të ashtuquajturën shkollë, shkollë në të cilën . në dy kontejnerë , mësojnë nxënësit shqiptarë dhe aty u njoftuam me një pozitë jashtëzakonisht të vështirë të komunitetit shqiptar, i cili jeton në Mitrovicë, në Kodrën e Minatorëve.

Duke pasur parasysh se Grupi i Unitetit , Qeveria dhe kryetari i Kosovës janë angazhuar dhe e kanë miratuar ndërtimin e një shkolle të mirëfilltë që e kishte rregulluar pozitën e komunitetit shqiptar atje, nuk është realizuar, **gjithashtu duke pasur parasysh që pushteti lokal.....**

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit znj. Teuta. Nëse doni vetëm të deklaroheni se cili është qëndrimi juaj lidhur me kërkesat e bëra.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Më mbeti vetëm pak kohë. Gjithashtu ,pushteti lokal për 22 muaj nuk e ka paguar transportin, prandaj mendojmë që qasja dhe kërkesa e këtillë nuk janë kërkesë e singertë. Mendojmë që kjo kërkesë për këtë çështje kaq të rëndësishme duhet të jetë një qasje sistematike e singertë dhe me Rregullore, e jo me çështje ad-hoc të rregullohet kjo çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryesues, të nderuar deputetë.

Mendoj që ka ardhur koha që rendi i ditës ose të formohet në seancë ose të formohet ashtu siç është **formuar** deri më tani, sepse mendoj që vërtetë po e teprojmë. Dihet që çështja e pjesës Veriore të Kosovës është mjaft e ndërlikuar dhe nëse është çështja për ato ndërtime apo rindërtime që bëhen atje mendoj që organet përkatëse duhet të kenë informacione. Duhet të kërkojmë nga Qeveria e pastaj mbi bazën e informacionit që e marrim nga Qeveria vërtetë duhet të debatojmë. Ne si grup parlamentar nuk kemi ndonjë informacion mbi bazën e të cilit duhet të debatonim sot. Edhe për çështjen e shëndetësisë mendoj që nuk është emergjente të bisedohet sot, por është e ngutshme që me një kërkesë me shkrim që e bën Grupi Parlamentar i PDK-së të kërkohej nga bordi ose superbordi i QKU-së që të raportojë se a është përmirësuar gjendja në shëndetësinë e Kosovës, apo është vështirësuar nga momenti kur është marrë kjo vërejtje e bordit, në mënyrë të paligjshme. Sa i përket pikës që e kërkoj shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së mendoj që kjo seancë është seancë e rregullt për të mbështetur qoftë dokumentin e Ahtisarit, qoftë Rezolutën e Parlamentit të Evropës, ky Parlament duhet ta organizojë një seancë që duhet të jetë pak më solemne dhe duhet t'i japë mbështetje. Është fat i mirë që Parlamenti i Evropës me dikund 490 vota i njeht sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës dhe mendoj që kjo duhet të jetë një seancë e veçantë, një pikë e **veçantë dhe duhet të ketë**.....

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Krasniqi. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit.

I nderuari z. kryesues, të nderuar ministra, deputetë të nderuar.

Lidhur me ngritjen e çështjeve për rendin e ditës, mendojmë se propozimi i bërë nga deputeti Ramadan Kelmendi është një çështje jo vetëm komplekse, por edhe e ndjeshme dhe kërkon informatë të saktë dhe të duhur për të debatuar për të. Prandaj konsiderojmë se kjo kërkesë duhet të futet në procedurën e rregullt ashtu që Kuvendi të mund të debatojë.

Sa i përket kërkesës së deputetes për diskutimin lidhur me gjendjen e shëndetësisë, ne kemi diskutuar tanimë disa herë lidhur me këtë dhe konsideroj se edhe kjo duhet të futet në procedurën e rregullt, duke saktësuar se çka nevojitet saktësisht lidhur me shëndetësinë.

Sa u përket kërkesave të tjera unë pajtohem me deputetin Krasniqi që tha se duhet një seancë e veçantë lidhur me kërkesën që e shtroi deputeti Lulzim Zeneli.

Kurse kërkesa e fundit që ishte lidhur me shtrenjtimin e çmimit të rrymës dihet se ajo është në kompetencë e Rregullatorit të Energjisë dhe ky është një organ i pavarur, ndërsa sa u përket kompetencave të Ministrisë, sipas njohurive që unë i kam e di që edhe Ministria ka reaguar në këtë. Këtu është edhe ministri i Energjisë dhe Minierave dhe nëse deputetët duan ndonjë informatë më të saktë mund edhe ai të japë informatën lidhur me këtë, por nuk mendoj se kjo sot është temë që duhet diskutuar. Edhe kjo duhet të shkojë në procedurën e rregullt. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Për fjalë është paraqitur në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Faleminderit z. kryesues. Fillimisht ,para se të deklaroj qëndrimin e Grupit Parlamentar për Integritet lidhur me çështjet e ngritura, më lejoni që ta informoj Kuvendin se prej sot në mesin tonë e kemi edhe deputeten e re të Kuvendit të Kosovës, e cila e ka zëvendësuar deputetin e ndjerë Rustem Ibishi. Është fjala për znj. Vezira Emrush që përfaqëson subjektin politik të Inisiativës Qytetare të Gorës. Më lejoni që ta shfrytëzoj rastin dhe t’ju them se znj. Vezira do të vazhdojë të ushtrojë aktivitetin e saj brenda grupit tonë parlamentar dhe shpresoj se do të jetë një kontribut i rëndësishëm për funksionimin demokratik të Kuvendit tonë.

Sa u përket çështjeve konkrete, unë personalisht dhe grupi ynë parlamentar mbështet qëndrimet e grupeve parlamentare të cilat lidhur me çështjen e ndërtimit kolektiv në Veri të Mitrovicës kërkojnë një informatë të detajizuar nga Qeveria dhe në bazë të saj të shtrohet një debat substancial lidhur me këtë çështje shumë më rëndësishme çështja e shëndetësisë është me të drejtë e ngritur nga deputetja Hadri ,e cila është në vijë të parë të shërbimeve në këtë aspekt dhe është shumë mirë e njoftuar me situatën reale. Gjithashtu grupi ynë parlamentar kërkon që të përgatitet një informatë detaje nga Qeveria lidhur me gjendjen në shëndetësinë e Kosovës lidhur me zbatimin e rekomandimeve të cilat ky kuvend i ka miratuar me rastin e shqyrtimit të zbatimit të ligjit për shëndetësinë. Po ashtu mbështesim edhe kërkesat e grupeve parlamentare për organizimin e një seance të veçantë parlamentare lidhur me deklarin e Parlamentit Evropian dhe qëndrimin e Kuvendit të Kosovës lidhur me pakon e Ahtisarit. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Në mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës së bashku me shefat e grupeve parlamentare në përgatitje të rendit të ditës për këtë seancë sipas procedurave me të cilat ne punojmë se rendi i ditës përgatitet para seancës e jo në seancë. Grupi Parlamentar i LDK-së e ka mbështetur pikën e 7 të rendit të ditës për raportin lidhur me Projektligjin për Ditën e Dëshmorëve.

**Më datën 29**, na ka ardhur në postat zyrtare kërkesa e Qeverisë për tërheqjen e këtij ligji nga procedurat parlamentare, andaj ju lutem që këtë çështje ta merrni në konsideratë. Qeveria e kryeministri e kanë shfrytëzuar të drejtën e vet që ta tërheqin ligjin dhe kjo sipas Rregullores mund të bëhet në të gjitha fazat, andaj kjo pikë është vështirë që mund të konsiderohet e radhitur në pikën shtatë. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit për ndihmën. Sipas deklarimeve të grupeve parlamentare, pothuajse të gjitha grupet parlamentare janë njëzëri të deklaruara që pikat e propozuara, e para nga Ramadan Kelmendi, e dyta nga Teuta Hadri, e treta nga Lulzim Zeneli dhe katërta nga Xhevat Bislimi. Për ta respektuar procedurën e rregullt, të informohen paraprakisht deputetët, të kërkojnë sqarime nga institucionet e tjera, nga Qeveria dhe kështu me radhë. Tani unë e kam obligim që ta qes në votim, por sipas qëndrimeve të kryetarëve të grupeve parlamentare mendoj që do të duhej të ndiqej kjo procedurë që të mos ju mendojmë as juve të votoni lidhur me këtë. Prandaj të nderuar

kolegë propozimet tuaja kërkoj t'i bëni me procedurë të rregullt përmes Sekretarisë së Kuvendit dhe në seancën e radhës Kryesia do t'i ketë parasysh që t'i radhitë në rend të ditës. Gjithashtu desha të informoj lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar për ta votuar ose për t'i dhënë legjitimitet në Kuvend LDD-së, sipas informata e vetmja është në procedurë. Unë nuk e kam në rend të ditës, Kryesia me siguri do ta shqyrtojë dhe në seancën e ardhshme do ta kemi në seancë plenare për ta miratuar.

Sa i përket tërheqjes nga rendi i ditës të pikës 7 mendoj që nuk kemi nevojë për deklaram, ai është qëndrim i Qeverisë-e ka tërhequr pikën dhe ne nuk do ta debatojmë sot këtë çështje. Ju informoj që pika 7 e rendit të ditës hiqet nga rendi i ditës.

Gjithashtu desha ta përshëndes deputeten e re Vezira Emrush dhe ta falënderoj deputetin më parë që ma mori obligimin tim që ta bëja këtë informacion. Ne e kishim në rend të ditës t'i informojmë deputetët, prandaj nuk po i përsëris fjalët tuaja. Ju uroj sukses në punën e mëtejshme.

Me këtë konsideroj se rendi i ditës është miratuar sipas renditjes duke e hequr pikën e 7 të rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

## 2. Miratimi i procesverbaleve dhe transkripteve të seancave plenare mbajtur me 14, 16 dhe 22 mars 2007.

Procesverbalet dhe transkriptet e seancave plenare të datave 16 dhe 22 mars, ndërsa seanca e 14 marsit është vetëm transkripto, sepse nuk ka pasur diçka tjetër, u janë shpërndarë deputetëve. Pyes deputetët a kanë vërejtje në procesverbalet dhe transkriptet e këtyre seancave? Nëse ka vërejtje mund të deklaroheni.

Për fjalë është paraqitur Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryesues.

Unë e kam një vërejtje në transkriptin e dt. 14 mars në faqen 13 kur kam thënë se do ta kemi mbikëqyrjen ndërkombëtare që do të mbikëqyrë aranzhimet e brendshme dhe jo pavarësinë, këtu është bërë “dhe jo vetëm”, prandaj kjo duhet të hiqet.

Sa i përket transkriptit të 22 marsit vërejtjet janë kryesisht në formulimin e fjalive, mendimin e fjalive, ku është vënë pika dhe presja dhe është dhënë një kontekst krejt tjetër, por unë këto të gjitha me shkrim to t'ia përcjell organit përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Unë po paraqitem për nja 2 gabime pak sa të rënda që janë bërë gjatë transkriptimit. Në faqen 63 radha e tetë, unë kam thënë ose kam propozuar që është koha të mendohet për një ligj për lustrifikimin, këtu ka dalë “justifikimi”, d.m.th është fjala për një ligj lustrifikimi, të saktësohet kjo se ia ka ndërruar kuptimin.

Në faqen 64, po ashtu rreshti i tetë, ka dalë sikur unë kam uruar që këto institucione i ruan gjithmonë policia e Serbisë, unë kam thënë që i ka ruajtur prej se janë bërë, se jo që i ruan gjithmonë. Ju ka ndërruar kuptimi, ka dalë si një lloj urimi.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Për fjalë është paraqitur deputeti Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryesues. Unë mendoj që për këto procesverbale e sidomos për transkriptet, kur flitet duhet të flitet në mënyrë rrënjësore. Unë jam njëri nga ata që kujdesshëm i lexon gjithmonë, është e palejueshme sa gabimet janë brenda tij dhe nuk është puna vetëm e gabimeve gjuhësore, dy kolegë më parë treguan në fjalimet e tyre se çfarë gabimesh të mëdha ka materiali. Unë po ju them se nëse i lexoni prej fillimit deri në fund në çdo fjalim ka gabime të natyrës katastrofike që e ndërron tingëllimi në këto aparate deri në vesh të atyre që e bëjnë transkriptimin, shkon keq. Unë nuk e di si vepron kjo teknikë, se nuk e di si dëgjohet atje, por kjo është e pamundur në çdo transkript ju keni ndërrim të konceptit me koncept. Duhet të bëhet diçka seriozisht për këtë punë. Ju e dëgjuat deputetin, thotë **lustrifikim** i del **justifikim**. Unë po ju them se ka gabime edhe më të tmerrshme se ky. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri

DEPUTETJA BESA GAXHERRI – Faleminderit z. kryesues, kolegë të nderuar. Nuk më mbetet pas kolegëve me shtu shumë, por vërtet këto janë transkripte, nuk janë procesverbale. Gjithë biseda dhe fjalimet incizohen dhe është shumë lehtë që të përshkruhen, andaj nuk tolerohen gabime çfarë bëhen. Po jap një shembull: Deputeti thotë **munden**, kurse në transkript shkruhet **s'mundet**. Ky është ndryshim shumë i madh, ose nuk duhet të bëhen, duhet të bëhet, këto janë ndryshime të mëdha. Ata që i shkruajnë këto transkripte absolutisht nuk e kanë vëmendjen e përcaktuar në atë tekst se çka shkruajnë, andaj është momenti i fundit për të reaguar dhe këto transkripte të jenë më në nivel. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bislim Hoti.

DEPUTETI BISLIM HOTI – Faleminderit z. kryesues. Unë do të jem shumë i shkurtër, duke pasur parasysh se në seancën e datës 9 shkurt, kur kemi biseduar për pakon e Ahtisarit, unë pata diskutuar edhe në një seancë më prapa, sepse në transkript mungon gjysma e diskutimit tim, andaj kaloj një kohë e gjatë. Unë edhe Sekretarisë ia kam dërguar edhe me shkrim dhe nuk e ka marrë të përmirësuar diskutimin tim!

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Unë nuk dua ta komentoj , përveç të konstatoj personalisht me qenë se mendoj se ky është më shumë problem i buxhetit të Kuvendit të Kosovës dhe i një vendimi të përbashkët. Kësaj fushe i nevojiten më shumë gjuhëtarë në Kuvendin e Kosovës dhe besoj që edhe Kryesia edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës do ta kenë parasysh, duke përfshirë edhe grupet parlamentare që të zgjidhet ky problem, përndryshe ne edhe në të kaluarën kemi thënë që ta ketë parasysh Sekretaria dhe administrata, por mendoj që pa një numër të caktuar gjuhëtarësh, përveç që do t'i dëgjojnë mirë dhe do t'i shkruajnë mirë do t'i përshtatin tekstet edhe logjikisht pak ma mirë.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

### 3. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve është e kufizuar në 50 minuta. Në afatet e përcaktuara me rregullore janë parashtruar 12 pyetje parlamentare. Pyetjet i janë dërguar Qeverisë dhe u janë shpërndarë të gjithë deputetëve.

Po fillojmë me pyetjen e parë të deputetit Ramadan Kelmendi për ministrin Agim Veliu. E ka fjalën nëse do me e përsëritë pyetjen.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari ministër. Unë do të jem shumë i shkurtër. Pyetjen kuvendore e kam paraqitur me shkrim, kërkoj përgjigje me gojë. Është shkolla fillore Isa Boletini në Boletin tani 3 muaj arsimtarët nuk marrin pagat. Ata thonë se janë në grevë urie, do të pësojnë fëmijët shqiptarë. Ajo shkollë menaxhohet nga Drejtoria për Arsim e komunës së Zveçanit, një situatë të ngjashme kam konfirmim se ishte edhe në Bistricë të Shalës. Vërtet janë vetëm këto dy shkolla që administrohen nga komunat serbe dhe gjendjen e kanë jashtëzakonisht të rëndë. A është ndërmarrë diçka, a do të ndërmerret dhe a do t'u dilet në ndihmë? Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Zotëri ministër e keni fjalën.

MINISTRI AGIM VELIU – Faleminderit z. kryesues. Të nderuar deputetë, të nderuar kolegë ministra, zonja dhe zotërinj.

Në pyetjen e deputetit Ramadan Kelmendi ju njoftoj se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për pagesën e të ardhurave mujore për mësimdhënësit e shkollës fillore Isa Boletini të Boletinit në komunën e Zveçanit dhe për shkollën fillore Kadri Bistrica të Bistricës në Komunën e Leposaviqit.

Të dy këto shkolla administrata e komunave Leposaviq dhe Zveçan nuk i ka futur në buxhetin e vitit 2007, prandaj Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka kërkuar ndihmën e Qeverisë dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

Në kërkesën tonë Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ka lejuar buxhetin për të dy shkollat fillore Kadri Bistrica në Bistricë, komuna e Leposaviqit dhe për shkollën fillore Isa Boletini në Boletin, komuna e Zveçanit. Për komunën e Leposaviqit buxheti është lejuar më dt. 18.03.2007, ndërsa për komunën e Zveçanit buxheti është lejuar me 22.03.2007. Mjetet e lartpërmendura buxhetore janë në dispozicion në Thesar dhe mund të shpenzohen menjëherë sipas procedurave të parapara për shfrytëzimin e mjeteve publike financiare. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Ju faleminderit. Zotëri Kelmendi keni pyetje shtesë.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Nuk kam. E falënderoj ministrin, gjendja është ajo që e thamë, ata nuk i kanë marrë pagat. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Deputetja Selvije Halimi ka pyetje për ministrin Ardian Gjini.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Faleminderit z. kryesues. Tashmë gati një muaj unë kam bërë një pyetje për ministrin Gjini, mirëpo si duket ka qenë shumë i zanë dhe nuk ka mund të prezantojë në seancë, megjithatë e falënderoj sot për prezencën.

Sipas ligjit për ujërat Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është e obliguar të hartojë strategjinë për ujërat në Kosovë dhe atë strategji pas aprovimit të Qeverisë ta dërgojë për aprovim në Kuvend. Pyetja është se a ka filluar Ministria e Mjedisit të hartojë strategjinë për ujërat në Kosovë?

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Ju faleminderit. Zotëri ministër e keni fjalën.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Faleminderit z. kryesues. Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Është një çështje të cilën e kemi përmendur edhe disa herë më parë. Unë sot do të përpiqem edhe një herë t'i përgjigjem. Znj. Halimi. Faleminderit për pyetjen. Është e vërtetë se në bazë të Ligjit për ujërat e Kosovës 2004/24 Ministria është e obliguar që të hartojë planin strategjik për ujërat. Nuk precizohet data, po ashtu ne duhet të hartojmë, të bëjmë përpilimin e planeve të përgjithshme. Ne e kemi përmbledh si strategji që në vend që të bëjmë disa plane ta bëjmë një plan strategjik për administrimin e ujërave të Kosovës që njihet edhe si master plan në zonat tona. Për hartimin e planit të tillë duhen mjete të shumta dhe ekspertizë. Ne kemi kërkuar nga donatorët që të na ndihmojnë, kemi marrë ndihmë deri më tani, mirëpo mendojmë se janë edhe disa çështje të cilat duhet ta përcjellin një master plan të ujërave, përpos mjeteve. Ai është plani i zhvillimit strategjik, plani hapësinor i Kosovës, për shkak se kemi konstatuar se nuk mund të kemi shpëputje të mëdha në mes këtyre planeve për shkak se një gjë e tillë do të na kthente prapë në riformulim të pjesëve serioze të planeve për shkak se duhet ta ndjekin njëri-tjetrin.

Megjithatë unë dua të them se përpos këtyre çështjeve evidente të cilat i përmenda ka edhe kufizime të tjera në të cilat Ministria ka hasur gjatë kësaj kohe e më kryesorja është mungesa e bazës së të dhënave deri në vitin 1999 d.m.th e kemi një periudhë 12 -13 vjeçare për të cilën nuk kemi bazë të të dhënave. Një kohë të caktuar nuk janë grumbulluar aspak shënime lidhur me ujërat në Kosovë, ndërsa pjesë e shënimeve janë tërhequr nga Serbia. Deri më sot ne punojmë në bazë të master planit të ujërave që është deri në vitin 2003 dhe ka elemente të cilat nuk janë përmbushur nga ai master plan i ujërave. Elementet kryesore që kanë të bëjnë me mos përmbushjen janë trajtimi i ujërave të zeza për të cilat kam folur para jush disa herë, ka qenë pjesë e master planit prej vitit 1983 deri në vitin 2003, mirëpo ju e dini se kam folur disa herë për koston e trajtimit të ujërave të zeza. E dini që ka pasur ndryshime kualitative, kuantitative. Gjithçka ka pësuar ndryshime prej vitit 83 deri në vitin 89 në Kosovë dhe ka mbetur pa u përmbushur, ndërsa pas vitit 1989 ka qenë e paimagjinueshme që Kosova të hyjë në trajtimin e ujërave të zeza, d.m.th ende kemi hapësirë të mjaftueshme me atë master plan të ujërave që t'i përmbushim edhe disa obligime, por prapë hasim në probleme financiare. Në fund të fundit është edhe çështja e kapaciteteve njerëzore. Të gjithë njerëzit të cilët merren me këto çështje e dinë se neve na duhet ekspertizë edhe nga jashtë për hartimin e master planit të ujërave, ne do të tentojmë si Ministri dhe si Qeveri që edhe në momentin kur e

marrim një mbështetje të ekspertëve nga jashtë ta shfrytëzojmë jo vetëm për ndërtimin e master planit të ujërave, por ta shfrytëzojmë edhe për ngritjen e kapaciteteve të brendshme në Kosovë ,në mënyrë që në të ardhmen të mos kemi nevojë për mbështetje të tillë. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe me planin hapësinor të Kosovës. Ne kemi marrë mbështetje shumë të madhe nga jashtë, mirëpo tani e kemi Institutin i cili është në gjendje të vazhdojë të punojë në këtë drejtim. Ju falënderoj për pyetjen. Është pyetje shumë me vend. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Faleminderit z. ministër. Znj. deputete a keni pyetje shtesë?

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Z. ministër, unë ju falënderoj për arsyeshmërinë që i bëni. Mirëpo është e kuptueshme që të gjitha strategjitë duhet të inkorporohen në strategjinë nacionale të zhvillimit dhe në strategjinë e planifikimit urbanistik të Kosovës, mirëpo ju e keni dorëzuar një draft të strategjisë së ujërave për hartimin e strategjisë nacionale të zhvillimit. Mbi çfarë baze e hartuat atë mini strategji për planin zhvillimor të Kosovës apo strategjinë nacionale të Kosovës? Gjithmonë gjeni justifikim te buxheti dhe te kapacitetet njerëzore. Duke e ditur se ky ligj është qe tri vite në fuqi- a keni menduar si Ministri të bëni avancimin apo të bëni përgatitje të kuadrit profesional me qenë se është një prej ministrive më të ndjeshme sa i përket mungesës së kuadrit profesional.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Ju faleminderit. Zotëri ministër e keni fjalën.

MINISTRI ARDIAN GJINI - Faleminderit edhe një herë z. kryesues. Të nderuar deputetë. Nuk përmenda inkorporim, përmenda harmonizim në mes planeve të ndryshme. Sa i përket avancimit të kuadrit në Kosovë po, por ne kemi shumë kuadro nga Ministria të cilët me ndihmën e donatorëve janë duke kryer studime posdiplomike jashtë vendit. Kjo është e saktë. Ndonjëherë mendoj se është shumë mirë që deputetët para se të parashetrojnë pyetje parlamentare të vijnë në Ministri dhe mund t'i marrin të gjitha shënimet. Unë sot këtu nuk mund t'ju jap për 5 minuta kohë me qindra faqe shënime të cilat i posedon Ministria për të gjitha këto që ju pyetët. Ju lus edhe një herë që kurdo që të keni kohë, secili i punësuar në Ministri duke filluar prej meje, është i gatshëm t'ju japë të gjitha shënimet që t'i keni në dispozicion për shkak se në atë mënyrë edhe mund të mprehen pyetjet dhe të arrijmë deri te ato pyetje të cilat që me të vërtetë janë pyetje.

Ju lus edhe një herë, kurdo që të keni kohë në Ministri, secili pjesëtar i Ministrisë është në gjendje cilën do kohë që t'ju përgjigjet. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Në radhë është pyetja e deputetes Rudina Bukoshit, pyetje e përsëritur për ministrin Astrit Haraqija, deputetja Rudina Bukoshi e ka fjalën.

DEPUTETJA RUDINA BUKOSHI – Ju faleminderit z. kryesues. Z. ministër, Projektligji për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë tashmë dy vjet e më parë është hartuar nga grupe ekspertësh vendorë dhe të huaj. Ky projektligj është në pajtueshmëri me

infrastrukturën rinore për të cilën është përgjegjëse kjo ministri. Po ashtu ky projektligj është në pajtueshmëri me Kartën Evropiane mbi pjesëmarrjen e të rinjve në jetën komunale dhe rajonale, me Letrën e Bardhë të Këshillit Evropian e të tjera.

Projektligji për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë është bazë për planin e veprimit të rinisë, i cili edhe është proceduar dhe inkorporuar në planin nacional të veprimit.

Zoti ministër; ku ka mbetur procedimi i mëtejshëm i këtyre dy dokumenteve thelbësore për zhvillimin dhe fuqizimin e sektorit rinor të Kosovës?

MINISTRI ARDIAN GJINI – I nderuar kryesues, të nderuar deputetë, të nderuar kolegë. E vlerësoj shumë interesimin e juaj lidhur me disa aspekte që kanë të bëjnë me rininë, në të cilën ju ngritni dy pyetjeve konkrete. Njëra që ka të bëjë me Ligjin për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, dhe tjetra lidhur me planin e veprimit për rininë në periudhën kohore 2007-2010.

Për sa i përket Projektligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë ju njoftoj se është hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me partnerët tanë, në radhë të parë me GTZ-në dhe i është dërguar Qeverisë në qershor të vitit 2006.

Ky projektligj më pas i është kthyer Ministrisë për rishqyrtim në gusht të 2006-shtës me arsyetim se Projektligji ka koston jashtëzakonisht të madhe financiare.

Ne si sponzorizues jemi duke rishqyrtuar edhe një herë këtë projektligj dhe në bashkëpunim me GTZ-në do të ulim koston e këtij projektligji, në mënyrë që sa më parë të procedohet në Qeveri dhe më pas me kohë për miratim. Në koston e lartë të këtij projektligji ka ndikuar edhe fakti se është paraparë të përfshihet edhe plani për veprim për rininë, dokumente këto të cilat duhet të shkojnë paralel- bashkë, sa i përket pyetjes së parë.

Kurse sa i përket pyetjes së dytë që ka të bëjë me planin e veprimit për rini i cili përfshin periudhën 2007-2010 mund t'ju informoj se Ministria e Kulturës e ka përfunduar hartimin e këtij plani dhe është inkorporuar në planin zhvillimor të Kosovës dhe pritet që së shpejti të miratohet nga Qeveria, për ta sjellë më pas këtu në Kuvend. Në kuadër të këtij dokumenti janë përfshirë të gjitha ministratë e Qeverisë së Kosovës të cilat merren me çështje të rinisë dhe të gjitha së bashku do ta zbatojnë dokumentin e rëndësishëm.

Prandaj, duke e ditur rëndësinë e këtij dokumenti kërkojmë edhe mbështetje nga Kuvendi i Kosovës. Ne jemi të vendosur, ndërkaq, në realizimin e politikave rinore gjatë periudhës 2007-2010 në partneritet me institucionet e tjera qeveritare, organizatat joqeveritare, pastaj edhe me sektorin privat dhe **komunitetin** e donatorëve.

Ju faleminderit

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, lidhur me pyetjen që i është drejtuar ministrit Qemajl Ahmeti.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë. Unë kam një pyetje për ministrin Ahmeti.

I nderuari Ministër Ahmeti. Përgjatë brezit rrugor të magjistrales Prishtinë – Podujevë shtrihet një numër i konsiderueshëm i shkollave fillore. Për shembull, në dalje të Prishtinës shkolla fillore “Hilmi Rakovica”, në fshatin Bardhosh shkolla fillore “Anton Zako Çajupi”, pastaj paralelja e ndarë e shkollës fillore “Nexhmi Mustafa” në Leban, shkolla fillore “Nexhmi Mustafa” në Besi, shkolla fillore “Nën Tereza” në Vranidoll dhe kështu me radhë.

Një numër i nxënësve të këtyre shkollave për të vijuar mësimin duhet të kalojnë, prej njërit krah rrugor në tjetrin, varësisht nga vendbanimi i tyre. Gjatë kalimit të rrugës nxënësit mund t’i ekspozohen rrezikut permanent për sigurinë e tyre. Për fat të keq në të kaluarën edhe kemi pasë raste të aksidenteve të shpeshta dhe humbje të jetës së nxënësve. Pyetja: Cilat janë aktivitetet dhe masat konkrete që Ministria i ka ndërmarrë deri më tani, ose, i parasheh t’i ndërmarrë në të ardhmen me qëllim që të rritet siguria në komunikacion përgjatë këtij magjistrali për të gjithë qytetarët dhe sidomos për nxënësit e këtyre shkollave dhe jo vetëm të këtyre?

Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar kolegë ministra, i nderuari deputet dhe zëvendësministër Brajshori .

Ministria e Transportit me strukturën e vet organizative është duke shqyrtuar të gjitha pikat e zeza në Kosovë, rreth rrugëve regjionale dhe magjistrale, që kanë të bëjnë me sigurinë rrugore, më konkretisht në këtë drejtim ka marrë hapat dhe ka identifikuar si pika të zeza në këto fshatra. Për këtë vit është planifikuar ndërtimi i një trotuari në fshatin Besi dhe këto pjesë të tjera do të bëhet sinjalizimi horizontal dhe vertikal pak më i theksuar në mënyrë që të kemi siguri më të madhe. Gjitha këto bëhen në bazë të buxhetit që posedon Ministria e Transportit.

Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Keni pyetje plotësuese?

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Unë falënderoj ministrin dhe nuk kam pyetje plotësuese. Besoj se do të ngritet shkalla e sigurisë në këtë magjistrat dhe në tjerat në Kosovë në përgjithësi. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Deputeti Ramandan Kelmendi, ka pyetje për ministrin Lutfi Hazirin, meqenëse nuk është këtu, kjo pyetje përcillet,...

Kryeministri ka përgatitur përgjigjen me shkrim. A doni ta lexojmë, apo po pritni kur të vjen ai në një seancë tjetër, apo jeni të kënaqur me këtë përgjigjet me shkrim?

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Unë kisha dëshiruar që të përgjigjet me gojë këtu në Kuvend, sepse është e karakterit të përgjithshëm dhe me rëndësi. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Atëherë të shtyhet për seancën tjetër. Deputeti Ibush Jonuzi ka pyetje për ministrin Sadik Idriz edhe ai nuk është këtu. Edhe deputetja Zylfije Hundozi ka pyetje për ministrin e Shëndetësisë, por ai nuk është këtu. Do të shtyhet për seancën tjetër. Deputetja Rudina Bukoshi ka pyetje për ministrin Ardian Gjini.

DEPUTETJA RUDINA BUKOSHI – Ju faleminderit z. kryetar. Zotëri ministër. Ka kaluar gati një vit nga nënshkrimi i një memorandumit të bashkëveprimit ndërmjet Ministrisë suaj dhe Kuvendit komunal të Prizrenit, për parandalimin e eksploatimit në mënyrë të egër të zhavorrit në brigjet e lumit Drini i Bardhë. Hapat konkretë për parandalimin e këtij fenomeni shkatërrues, dhe dhunues ndaj natyrës, kanë qenë fare pak të dukshëm.

Z. ministër ç’po ndodhë sot me planin operativ për parandalimin e eksploatimit të zhavorrit në Drinin e Bardhë? Bashkangjitur, besoj se i keni edhe letrën dhe reagimin e banorëve të asaj zone

KRYETARI KOLË BERISHA - Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit z. kryetar edhe një herë deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit zonja deputete për pyetjen. Është një çështje e cila ka qenë ndër pikat kryesore, të cilat i kam ndjekur që prej momentit që e kam marrë detyrën si ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Përgjigjja fillimisht do të jetë kështu. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor e ka hartuar metodologjinë e projekt propozimit për planin lokal të veprimit në mjedis. Na duhen edhe të dhënat e sakta të cilat duhet t’i marrim prej komunës. Pjesa tjetër e pyetjes është për veprimtarinë e Ministrisë në këtë drejtim ose implicit dhe do t’jua lexoj vetëm një tabelë, shumë të shkurtër e cila është kështu.

Aktivitetet e Ministrisë kanë qenë këto: Inspektimet në teren dhe incizimi i gjendjes. Në Kosovë kanë ndodhur 234, vetëm në Prizren, 48. Kontrollimet në terren nga inspektorati, 178 në Kosovë, 39 vetëm në Prizren. Vendosja e shiritave për ndërprerje të përkohshme të punës së operatorëve, 69 në Kosovë, 13 vetëm në Prizren. Vendimet për ndërprerje të përkohshme të punës gjersa operatorët të pajisen me leje përkatëse- 69 në Kosovë ,vetëm 13 në Prizren dhe përcjellja e padive për kundërvajtje në gjykatat komunale, 20 në Kosovë, 2 në Prizren.

Pjesa tjetër e cila do të kishte plotësuar përgjigjen është kjo: Prej momentit kur është nënshkruar vendimi administrativ që thashë edhe një herë është nënshkruar në qershor para 2 viteve shumë shkurt pasi që kam ardhur në Ministri, ne nuk e kemi pas asnjë iluzion se do të kalojnë vetëm 6 muaj ose 1 vit dhe kjo veprimtari do të përmbyllet. Mirëpo në atë moment ia kemi filluar një punë e cila ka qenë e domosdoshme të fillohej në këtë drejtim. Mendoj se deri më tani asnjë gjykatë nuk e ka marrë asnjë vendim për ndërprerjen e punës së operatorëve. U kemi shkruar letra, u jemi drejtuar. Mendoj se edhe ju, si deputet edhe gjithë deputetët e tjerë, të gjithë qytetarët e Kosovës mund t'ju drejtohen për shkak se ai udhëzim administrativ i jep të drejtë çdo individ në Kosovë, jo vetëm Ministrisë që të ngrejë padi ose të paraqesë rastin, për çfarëdo rasti të shkeljes së kësaj natyre për shkak se është një vepër e cila është e dënueshme dhe nëse dikush pret që vetëm Ministria të punojë në këtë drejtim, atëherë mendoj se ne nuk do të arrijmë që ta ndalim këtë veprimtari. E fundit është se na duhen edhe dy udhëzime të tjera administrative për ta përmbyllur ciklin e ndalimit të shfrytëzimit të **inerteve të ...** ato dy udhëzime administrative nuk i nxjerr Ministria e Mjedisit dhe duhet të koordinohemi në këtë drejtim. Prapëseprapë duhet të bëjmë pyetje edhe nëpër komuna edhe nëpër inspektorate komunale, edhe nëpër gjykata, edhe te vetë qytetarët të cilët në momentin kur i drejtohen ministrit i cili është plotësisht legjitim kishte me qenë mirë t'i drejtohen edhe gjykatës edhe policisë. Ju faleminderit.

KRYTARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Nuk ka.

Kalojmë në pikën e 4 të rendit të ditës.

4. Interpelanca e ministrit të Ekonomisë dhe të financave, z. Haki Shatri, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-së

Në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar ORA i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë ministrin e Ekonomisë dhe Financave z. Haki Shatri. Në afatin e paraparë me Rregullore, ministri i është përgjigjur ftesës për interpelancë.

Sipas rregullës 25.7 Grupi Parlamentar i cili ka kërkuar interpelancë, mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje prej 10 minutash. Urdhëroni z. Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuar ministër, të nderuar kolegë deputetë. Fillimisht do të kisha dashur pa pretendime të mëdha ta diskutoj çështjen e zbatimit të Rregullores lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pra lidhur me interpelancën. Ne, siç e dini, e kemi ndryshuar Rregulloren e punës që ta bëjmë këtë pikë më efektive, që kjo pikë ta fitojë një peshë më të madhe. Pra, kjo armë parlamentare, interpelanca, ta fitojë një peshë dhe një rëndësi më të madhe në komunikimin tonë Parlament- Qeveri dhe që të përpiqemi ta rrisim efektivitetin e punës së Qeverisë.

Mendoj se do të duhej që zbatimi i kësaj pike të Rregullores së punës, pra i pikës 25, që ka të bëjë me interpelancën të përmirësohet dhe të saktësohet konform Rregullores së punës. Ne si grup parlamentar e kemi parashtruar kërkesën më 1 mars e kemi protokolluar. Më 5 mars Kryesia ka marrë vendim që kjo të procedohet në Qeveri, e ka

trajtuar Kryesia. Sipas Rregullores së punës duhet që Qeveria brenda 7 ditësh të kthejë përgjigje, pra **Rregulla 25.5, 5+7 bëjnë 12** z. kryetar, pra më 12 mars kjo përgjigje është dashur të jetë këtu. Meqenëse kjo përgjigje nuk ka ardhur deri më 12 mars. Z. kryetar është dashur të futet si pikë e rendit të ditës të seancës së parë të ardhshme. Ne kemi pasur seanca më 15, kemi pasur seancë më 21 dhe kjo nuk është përfshirë në rendin e ditës. Përgjigja e Ministrisë ka ardhur tek më 21 mars, pra jo në afatin e paraparë, por larg pas afatit të paraparë. Nuk kam thash, pretendime të mëdha, por tërheq vërejtjen që kjo procedurë të automatizohet për hir të efektivitetit të punës së Kuvendit dhe për hir edhe të një discipline më të madhe në kuadër të Qeverisë.

Tash po përpiqem të hyj në temë, sepse diskutimi në këtë kontekst kohor lidhur me këtë pikë të rendit të ditës mua më duket ndoshta paksa absurd, duke marrë parasysh zhvillimet pozitive në arenën ndërkombëtare lidhur me Kosovën dhe mund që edhe aspekti i funksionimit tonë pozitiv dhe opozitë ta humb atë kuptimin e mirëfilltë të vetin, mirëpo një gjë kurrë nuk duhet ta humb kuptimin në këtë Kuvend.

Patëm rastin edhe mbrëmë ta dëgjojmë kryetarin e Kosovës, z. Sejdiu, të fliste për ligjet e miratuara në Kuvendin e Kosovës, si ligje të mira, ligje të cilat kryesisht i përmbushin kriteret, mirëpo edhe ai vetë shprehu pakënaqësi me zbatimin e ligjit dhe pikërisht këtu dua të ndalem.

Z. Gashi, unë i kam 10 minutat e mia për ta hapur këtë çështje për diskutim. Ju sigurisht keni me i pasur minutat tuaja për t'i kundërshtuar pohimet e mia. Z. ministër interpelanca jonë ka të bëjë me një çështje që është fundamentale për këtë shoqëri, pra çështjen e menaxhimit të buxhetit të Kosovës. Je njeriu më i thirrur për t'i respektuar ligjet lidhur me këtë aspekt të funksionimit të shoqërisë. Siç e dini, Kuvendi i Kosovës ka pas ngritur një Komision hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës lidhur me raportin e auditorit të përgjithshëm, dhe Komisioni hetimor të nderuar kolegë deputetë, ka konstatuar që Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk i ka respektuar dispozitat ligjore duke lejuar pagesën e veturës së blinduar nga vija buxhetore për renovimin e objekteve të Kuvendit.

Ky raport i Komisionit hetimor të ngritur nga ky Kuvend, nga të gjitha grupet parlamentare dhe në përbërje të gjitha grupeve parlamentare është votuar në këtë Kuvend dhe përderisa është votuar në këtë Kuvend, ai raport është dokument i ligjshëm dhe zyrtar i këtij Kuvendi, pra ku konstatohet që Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk i ka respektuar dispozitat ligjore lidhur me çështjen për të cilën po diskutojmë. Unë i kam këtu para vetit disa nene të ligjeve të miratuara në këtë Kuvend, të cilat flasin për obligimet që dalin nga ana e zyrtarëve të institucioneve tona lidhur me problemet e ndryshme, e kemi nenin 27: rregullimet e përvetësimeve të organizatës buxhetore, ku neni 27.1 thotë: ministri i Ekonomisë dhe Financave nëse merr një arsyetim të vlefshëm nga një udhëheqës i një organizate buxhetore, kurse udhëheqësi i organizatës buxhetore në përshkrimin e definicioneve është individ i cili e mbanë pozitën më të lartë në një organizatë buxhetore, në atë rast mund ta autorizojë transferimin e një shume të caktuar nga një përvetësim i asaj organizate buxhetore në një përvetësim tjetër të organizatës së njëjtë me kusht që vlera e shumës së transferit të mos jetë më e madhe se 20%.

Unë mund ta kuptoj që zoti ministër nuk e ka marrë këtë vendim. Mund ta kuptoj që ndonjë zyrtarë atje në thesar ose në ministrinë e tij, krye në vete e ka kryer këtë bartje të mjeteve nga një pozicion në një pozicion tjetër, mirëpo përderisa z. ministër nuk e ka informuar opinionin publik se ka marrë ndonjë masë ndaj ndonjë zyrtari i cili e ka shkaktuar këtë shkelje të ligjit, pra këtë cenim të ligjshmërisë në Kosovë, atëherë më mbetet të supozoj që asnjë zyrtarë në ministrinë e tij nuk e ka bërë këtë punë pa miratimin e ministrit.

Rrjedhimisht pra është ministri përgjegjësi kryesor i cili e ka mundësuar këtë shkelje të paligjshmërisë dhe këtë shkelje të ligjit, dhe kjo shkelje e ligjit të nderuar kolegë deputetë ka pasur si pasojë dëmtimin e buxhetit të Kosovës për 236 mijë euro. Kur them dëmtimin them, sepse qëllimi ka qenë blerja kurse blerja që thuhet se është kryer dhe thuhet që mjete i cili është blerë është pranuar në Kuvendin e Kosovës, mirëpo Komisioni hetimor i ngritur nga ky Kuvend konstaton që ai mjet nuk ka ardhur kurrë hiq në Kuvend. Pra, dikush ka përfutur nga një vendim i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave 236 mijë euro, sepse paratë janë dhënë, kurse mjete i cili është supozuar të blihet nuk ka ardhur në Kuvend.

I kam këtu edhe disa dispozita të Kodit Penal të Kosovës. Është neni 339, shpërdorimi i pozitës zyrtare ku thuhet: „Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo shkakut të dëmit për personin tjetër ose për organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbushë detyrat zyrtare, dënohet me burgim deri në një vit”. Pra këtu kemi një rast i cili është shumë problematik, që ka të bëjë edhe me rrjedhoja lidhur me Kodin Penal të Kosovës, sepse dikush ka përfutur nga një vendim i marrë i paligjshëm nga ana e Ministrisë dhe i ka futur në xhep 236 mijë euro.

Unë e kam shumë të qartë që Kodi Penal është një kod i cili u takon të tjerëve që ta zbatojnë. Unë këtë e lexova vetëm sa për informimin tuaj, kurse sa u përket përgjegjësiave politike të personave, të zyrtarëve të lartë të emëruar nëpër poste, mendoj se ne jemi ata që jemi të thirrur ta konstatojmë këtë përgjegjësi. Sigurisht që ne opozita jemi këtu për t'i ngritur problemet. Jemi këtu për ta tërhequr vëmendjen tuaj, të nderuar kolegë deputetë, që e përbëni shumicën parlamentare këtu për shkeljet dhe është në dorën tuaj t'i merrni vendimet, sepse sigurisht që po t'i kishim ne në dorën tonë t'i marrim vendimet, ne do t'i kishim marrë në pajtim me shqetësimet që po i ngrisim para jush, mirëpo duke pasur parasysh që shkeljet janë evidente, janë drastike, unë kisha kërkuar nga ju që të ngriheni në përgjegjësi dhe që ta merrni vendimin e duhur dhe më të mirë të mundshëm në pajtim me përgjegjësinë politike të çdo zyrtari.

Demokracia, të nderuar kolegë deputetë, nuk mund të ndërtohet pa respektim të ligjit. Nuk ka demokraci pa rend dhe pa ligj, prandaj sa herë që ndodh të shkelet ligji, duhet të veprojnë mekanizmat që e mbrojnë ligjin. Në qoftë se kjo nuk ndodh, atëherë unë e shtroj pyetjen para jush: Ku po shkojmë? Në qoftë se pretendojmë që po shkojmë në demokraci, unë dyshoj shumë, sepse sjellja e tillë e cila nuk e sanksionon shkeljen e ligjit, nuk dëshmon se ne po shkojmë në demokraci. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. z. Shatri e keni fjalën.

MINISTRI HAKI SHATRI – Ju faleminderit shumë. I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, kolegë ministra dhe të pranishëm.

Dëshiroj në fillim t'i përgjigjem vërejtjes së vonesës, ose lidhur me vonesën e përgjigjes së ministrit të Financave për interpelancë. Me të marrë shkresën lidhur me kërkesën e grupit parlamentar ORA, ministri i Financave është përgjigjur pozitivisht me shkrim dhe kam treguar gatishmërinë, por edhe kam kërkuar mirëkuptim nga Kryesia e Kuvendit që në javën e dytë të marsit të mos ta hedhë në diskutim këtë çështje, sepse do të jem në udhëtim zyrtar në SHBA, por me t'u kthyer, menjëherë e kam bashkangjitur materialin bashkë me përgjigjen dhe e kam proceduar për Kuvend.

Unë kam proceduar përmes Zyrës së Kryeministrit, sepse ajo është rruga dhe nuk e di a ka mbërritur deri te parashtruesi i kërkesës. Nga ana ime kjo punë është bërë me kohë.

Të nderuar deputetë dhe të pranishëm

Kam nderin dhe vërtet jam i lumtur që kam rast sot të prezantoj lidhur me rastin në fjalë, sepse është bërë shumë fjalë dhe ka pasur shumë aludime gjoja për përgjegjësinë e ministrit dhe të Ministrisë së Financave lidhur me procedimin e pagesës për veturën e kryetarit të Kuvendit.

Në bazë të kërkesës së Grupit Parlamentar ORA, sot paraqitem në interpelancë për të dhënë sqarim lidhur me zbatimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë përkitazi me “Lejimin jo ligjor të pagesës së veturës të blinduar nga vija tjetër buxhetore”. Kështu shkruhet në shkresën zyrtare që unë kam marrë.

Dëshiroj të theksoj që në fillim se Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe në kuadër të saj, as Departamenti i Thesarit, i cili kryen procedimin e pagesave të shpenzimeve publike, nuk kanë bërë asnjë shkelje të dispozitave të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe as të Urdhëresës administrative mbi procedurat e shpenzimeve me rastin e procedimit të pagesës së veturës për Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, as ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave nuk mund t'i mvishet ndonjë lloj përgjegjësie për rastin në fjalë, pasi që pagesat e përditshme që procedohen në Thesar nuk kanë as nevojë të marrin pëlqimin e ministrit, sepse Departamenti i Thesarit është krejtësisht i pavarur në kryerjen e detyrave të punës, veçanërisht të atyre operative. Konkretisht, pagesa e proceduar nga Thesari nr. 35612 në shumë prej 236.500 euro për Thesarin ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara me Ligj dhe me Urdhëresën administrative. Procedurat e shpenzimit të parave publike janë përcaktuar në kapitullin 7, nenet 31 deri 36 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të shpallur me nr. 2003/2 dhe janë specifikuar në Urdhëresën administrative nr. 1/99 mbi procedurat e shpenzimeve.

Pagesa në fjalë është shoqëruar me urdhër obligimi dhe me dokumentet në vijim, që janë të nevojshme dhe të parapara në këtë dokument. Urdhër- obligimin për pagesë me nënshkrim të zyrtarëve të autorizuar dhe të certifikuar me nr. 64651/2005 të datës 21.11.2005, e kam me vete( këtë dokument), fletëporosia me të dhënat e furnitorit e dt. 18.10.2005 dhe me nënshkrimin e personave përgjegjës të Kuvendit.

Po ashtu e kam të bashkangjitur me diskutimin tim faturën e furnitorit me nr. TFA/ASS 03/2005 të regjistruar me nr. 7002 405 75 të datës 24.10.2005. Po ashtu është e bashkangjitur Kontrata valide nr. ASS VIP 01/2005 e lidhur ndërmjet porositësit dhe furnitorit. Po ashtu i kemi të bashkangjitur raportin e pranimi të veturës nga zyrtarët e Kuvendit të dt. 25.11.2005 dhe kërkesën e sekretarit të Kuvendit drejtuar Agjensionit të prokurimit publik për lejimin e procedurave të negociuara. Po ashtu e kemi të bashkangjitur dhe të aprovuar kërkesën nga ana e Agjensionit të Prokurimit Publik për procedurat e negociuara. Këto janë dokumente të cilat normalisht i duhen Thesarit për të proceduar çfarëdo lloj pagese që vjen gjatë ditës në thesar. Nuk ekziston asnjë dokument, pra nuk ka pasur kërkesë nga ana e Kuvendit të Kosovës drejtuar Ministrisë së Financave për transfer të mjeteve nga një kategori apo kod në tjetrin dhe prandaj nuk ka lejim për transfer nga Ministria e Financave nga një kategori në tjetrën. Në bazë të të dhënave që disponojmë, pra dokumentit të buxhetit për vitin 2005, organizata buxhetore- Kuvendi i Kosovës, në vitin 2005 kishte mjete të alokuara të mjaftueshme për realizimin e furnizimit të caktuar dhe, siç mund të shihet në këtë dokument, kishte bërë zotime të nevojshme të shumës së parave për këtë furnizim, si parakusht për fillimin e procedurës për furnizimin e negociuar.

Përndryshe, për sqarim për deputetët, që nga viti 1999 deri në vitin 2006, pra deri në fund të vitit 2005, në bazë të rregullave në fuqi, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe Thesari sistemin e kontrolleve e kanë realizuar vetëm në 4 nivele. Po e përmend. Ndarja buxhetore e aprovuar me Rregullore të buxhetit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe e autorizuar nga PSSP-ja, në rastin konkret, buxheti i vitit 2005 i autorizuar me Rregulloren 2005/12 dhe i ndryshuar me rastin e rishikimit të buxhetit. Niveli tjetër, alokimi i mjeteve bazuar në rrjedhën e parësë., kategoria ekonomike bazuar në klasifikimin e statistikave financiare qeveritare, publikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Dhe e fundit, zotimi i mjeteve përmes sistemit informativ për menaxhimin e financave publike të Kosovës. Këto janë katër nivele që deri në fund të vitit 2005 Thesari i ka pasur si bazë për të proceduar një pagesë, çfarëdo qoftë ajo.

Të nderuar deputetë,

Siç po e shihni, në vitin buxhetor 2005 nuk ka pasur sistem të kontrollit për projektet individuale në kategorinë e investimeve kapitale, dhe si rrjedhojë, për sqarim nuk ka pasur transfer nga një kod në tjetrin, meqë nuk ka pasur nevojë, sepse paratë kanë qenë në kategorinë në kodin e investimeve kapitale dhe furnizimi është bërë po nga ajo kategori,pra me vendim të vet organit kompetent të organizatës buxhetore. Pas përvojës dhe praktikave pozitive që kemi bërë në vitin buxhetor 2006 dhe në vazhdim, ndarjet buxhetore Ministria e Financave i ka përcjellë edhe në bazë të projekteve individuale të cilat në aneks të dokumentit të buxhetit shoqërohen me të dhënat përkatëse. Tani, sipas

kësaj metode të kontrollit të shpenzimeve, në rast se organizata buxhetore dëshiron të ndërrojë destinimin për projektin edhe brenda të njëjtit kod duhet të bëjë kërkesë për të përfillur procedurat në fuqi. Për të qenë i qartë, ndoshta po e përsëris, po theksoj se Kuvendi i Kosovës në rastin konkret nuk ka bërë kërkesë për ndërrim destinimi të mjeteve, sepse në kategorinë e shpenzimeve ka pasur para të mjaftueshme për furnizimin në fjalë. Pra, nuk ka lejm të ndryshimit të kodit dhe të kategorisë së shpenzimeve nga ana e ministrit as Thesarit të Ministrisë së Financave.

Dëshiroj të sqaroj, për ata që nuk kanë pasur rast për procedim pagesash, në Thesar të Ministrisë së Financave nga 60 organizata buxhetore- sa ka, çdo ditë procedohen dhjetëra, qindra pagesa dhe për asnjërën nuk ka nevojë të njoftohet ministri dhe as të merret pëlqimi apo miratimi i ministrit. Prandaj, pretendimi për të ngarkuar ministrin me përgjegjësi për një veprim që nuk ka pasur nevojë ta bëjë dhe që nuk e ka bërë, nuk qëndron.

Më lejoni në fund që edhe një herë të shpreh kënaqësinë time për rastin e dhënë që publikisht para deputetëve të Kuvendit, të prezantoj dëshmitë lidhur me respektimin e rregullsisë së procedimit të pagesës në fjalë dhe të shpreh gatishmërinë time që kurdoherë që kërkohet të bashkëpunoj qoftë me komisione hetimore, siç ishte ky për të hetuar të gjeturat faktike të auditorit gjeneral, në Kuvendin e Kosovës, qoftë në komisionet e rregullta të Kuvendit. Këtë që po e them e kam dëshmuar edhe në bashkëpunimin me Komisionin Hetimor, ndoshta me ndonjë mangësi të vogël, por shpresoj që keni pasur mirëkuptim.

Shpresoj që prezantimi im ka përmbushur kërkesën e Grupit Parlamentar ORA dhe, po ashtu, jam në dispozicion të përgjigjem në pyetjet e tjera lidhur me këtë çështje, por vetëm sa i përket përgjegjësisë së ministrit dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

Nuk dëshiroj dhe nuk jam kompetent për t'u përgjigjur për obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e organizatave buxhetore, e as të personave kompetentë në organizatat buxhetore, sepse kjo u takon agjensioneve shpenzuese, kurse validitetin e dokumentacionit dhe procedurat brenda organizatave buxhetore i vlerëson një organ kompetent, në rastin konkret auditori gjeneral.

Ju falënderoj për vëmendje dhe për durim dhe jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet shitesë.

Ju faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! A ka pyetje shitesë? Nuk ka. Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK-së ta marrë fjalën.

**DEPUTETI ALUSH GASHI** – Ju faleminderit z. kryetar. Ne si grup parlamentar jemi angazhuar në respektimin e plotë të **Rregullores së punës** së Kuvendit. Kemi mirpritur kërkesën për interpelancë. Si grup jua përkujtojmë se lidhur me këtë çështje ne kemi

marrë pjesë në debatin e seancës plenare, pas debatit janë miratuar rekomandimet lidhur me këtë çështje dhe ne presim që rekomandimet të zbatohen. Angazhohemi për transparencë të plotë dhe për sundim të ligjit dhe kjo çështje të rregullohet ashtu si është paraparë me ligj.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të PDK-së Safete Hadergjona

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë.

Bazuar në librat e buxhetit të cilët për çdo vit i nxjerr Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kjo ministri e ka këtë mision. Ministria e Ekonomisë dhe Financave është përgjegjëse për koordinimin dhe menaxhimin financiar të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave fiskale dhe të sistemeve administrative, për zbatimin e sistemit të kontabilitetit, të thesarit qendror dhe Administratës Tatimore.

Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që nga fillimi i punës së tij e ka shkelur misionin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, sepse ka dështuar në menaxhimin e buxhetit të Kosovës, në zhvillimin e politikave fiskale dhe ka dështuar dhe në politikat në administratën tatimore. Ne sot në këtë interpelancë e kemi çështjen e specifikuar. Po ndalem vetëm te kjo çështje. Ato materiale të cilat na i prezantoi zoti ministër ne na i ka ofruar në Komisionin Hetimor më 22.01.2007, ku thotë se: materialet lidhur me çështjen e veturës së blinduar, bashkangjitur gjenden argumentet dhe materialet e bashkangjitura nga Departamenti i Thesarit, d.m.th. këtij materiali pra i bashkëngjiten argumentet që kanë të bëjnë me blerjen e veturës. Nuk e di nëse ministri i ka shikuar atëherë po sot i tha këtu po llogaris që i ka shikuar. Nëse i shikojmë argumentet që ju i keni sjellë, atëherë ju keni përgjegjësinë që ju keni lejuar pagesën prej 236500 euro.

Materiali me argumente, ka qenë dëshmia më e mirë, sepse është duke u kryer një pagesë e dyshimtë dhe është duke u shkelur ligji. Nga materiali shumë lehtë mund të vërehet se ka dyshime në pagesën e mjeteve. Sigurisht në këtë material ju keni vërejtur shkresën e datës 23.3.2005 për prokurimin njëburimor, sepse është këtu në këtë material të bërë nga sekretari i Kuvendit për shefin e Agjensionit për Prokurim Publik, me arsyetimin se prokurimi i zakonshëm kërkon 4 deri 6 muaj kohë dhe nuk mund të bëhet duke u bazuar në kërkesë sekrete. Me këtë arsyetim ata kanë qenë të detyruar të shkojnë në prokurim njëburimor, sipas tij personeli ka identifikuar dy automjete të gatshme për dorëzim brenda afatit 7 ditor.

Keni pasur edhe shkresën e aprovuar nga Agjensioni i Prokurimit Publik, pra, edhe kjo shkresë është në këtë material për procedurat e negociuara, pa publikimin e njoftimit të kontratës për blerjen e veturave në vlerë prej 750 mijë euro, për blerjen e dy veturave.

Si u lejua të bëhet pagesa për prokurimin njëburimor pas 8 muajsh kur në shkresë shkruan fortë mirë që janë identifikuar dhe brenda 7 ditëve makina do të jetë në Kosovë.

Duke bërë këtë pagesë ju keni shkelur edhe ligjin. Sigurisht e keni vërejtur edhe urdhëresën për ridestinimin, pra këtë urdhëresë që e keni në këtë material për ridestinimin e mjeteve kapitale të bërë nga sekretari i Kuvendit, drejtuar drejtorit të departamentit të buxhetit të Kuvendit që nga zotimi me vlerë prej 953967 euro i bërë për Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi të përdoret për blerjen e veturës së blinduar me vlerë prej 236500 euro.

Atëherë, meqë nuk kemi ndonjë dëshmi tjetër, ju sigurisht është dashur të ndienit përgjegjësi dhe të shpjegoni urdhërobligimin për pagesë nr. 35612 që e theksuat ju me numër zotimi 64561, në çka jeni bazuar që keni lejuar një zotim të ri të tillë të bërë më 21.11.2005 dhe aq më keq pagesën e bërë më 25.11.2005.

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe për përgjegjësitë e ndalon një pagesë të tillë. Ligji për menaxhim të financave kërkon që të gjitha shpenzimet të bëhen nga alokimet e ndarjeve buxhetore.

Nëse ju i lejoni pagesat e tilla pa kurrfarë procedure atëherë pse të bëhet planifikimi dhe çka na duhet ligji?

Zoti ministër, neni 15.1 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësiive thotë se: Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, asnjë organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojë. të abuzojë, ekspozojë apo të përdorë në mënyrë të parregullt paratë publike.

Neni 35 thotë: Nuk do të lejohen asfarë mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për pagesa ku nuk ekziston njoftimi për akordimin e fondeve faktike, efektive që autorizojnë përdorimin e të hollave për pagesa të tilla.

Neni 15.2, po jua rikujtoj ,i këtij ligji thekson që një shpenzim i parave publike do të bëhet vetëm nga fondet e alokuara dhe vetëm në pajtueshmëri me procesin që është vendosur me rregullën financiare në pajtim me nenin 35.2. rregulla financiare është se të gjitha organizatat buxhetore duhet të dorëzojnë planet e detajuara të rrjedhës së parasë për të marrë alokimin e fondeve, d.m.th. ky projekt për blerjen e makinës apo kjo blerje nuk është e paraparë me planet detale që i janë ofruar Ministrisë.

Ju e dini z. ministër se Ligji i menaxhimit të financave publike kufizon mundësinë e transferimit të ndarjeve buxhetore, për këto transfere kërkohen disa aprovime. Kërkesa për transfer duhet t'i drejtohet Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave që ka disa procese dhe formularë për të kërkuar transfer.

Thesari deklaron në ato argumente që ju i quani se nuk ka pasur informata se nuk i ka pasur ato argumente, d.m.th. që ju i keni ofruar, Thesari thotë se nuk ka pasur informata për ridestinimin e projekteve, atëherë shtrohet pyetja.

si është bërë dhe në çfarë baze është bërë pagesa për një projekt krejtësisht tjetër? Nga të gjitha këto dokumente që i kemi në dispozicion shihet haptas se është shkelur ligji dhe është dëmtuar rënd buxheti. Meqë ju po arsyetoheni është e drejtë juaja

Për arsyetim në shkeljen e ligjit atëherë çfarë masash keni ndërmarrë ndaj atyre që kanë shkelur ligjin. Unë do ta kisha bërë edhe një pyetje: A është diskutuar ndonjëherë në Qeveri çështja e blerjes së këtyre veturave gjatë mbledhjeve të juaja, a ka pasur farë diskutimi, a ka qenë i njoftuar edhe kryeministri për një pagesë të tillë dhe për një blerje të tillë? Në një prononcim për media ju patët thënë se po bëni planifikim të mirë të buxhetit dhe keni marrë lëvdata nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nga organizatat e tjera, sepse nuk ua keni ndërruar destinacionin mjeteve, por mjetet kanë shkuar aty për çka janë planifikuar. Por kjo çfarë është, a kanë shkuar mjetet për çka janë planifikuar apo janë shkuar diku tjetër? A jeni në dijeni sa ndërrime të tilla të kundërligjshme të destinacionit të mjeteve janë bërë nëpër ministri gjatë kohës kur ju keni menaxhuar buxhetin? Ju keni shkelur haptas Ligjin për menaxhimin e financave publike me transferin që keni bërë në prill të vitit 2005, të një milion eurove nga Ministria e Shërbimeve Publike në Presidencë. Në këtë rast ju deklaroni se na ka bërë vërejtje Zyra fiskale që nuk është legale të bëjë kalimin prej një organizate buxhetore. Me propozimin e Zyrës fiskale këto mjete janë rikthyer në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe janë mbuluar nga rezervat e ministrit. E kujt është përgjegjësia me këtë rast? Këto fjalë janë marrë nga transkripti i datës 24.04.2006, në dëgjimin publik që është bërë për shqyrtimin e pasqyrave financiare për vitin 2005. Ju z. ministër që menaxhoni buxhetin nuk besoj se nuk e keni ditur se çfarë do të thotë neni 21 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësive, por interesat individuale, grupe dhe politike të këtij koalicioni qeverisës ishin mbi ligjin, mbi rregulloret dhe mbi interesat e qytetarëve. Ashtu siç nuk e besoj që nuk e keni ditur edhe që garancioni bankar për “Kosmocell”-in nuk është valid, më 28 shkurt ju thuani: “Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave çdo ditë kryhen mijëra pagesa, kështu që unë nuk mund t’i **hallakas** të gjitha ato për t’i parë se kush ka paguar e kush nuk ka paguar”, kështu disi thatë edhe sot. Mirëpo, kjo nuk të arsyeton për shkeljen e ligjit të cilin je i detyruar ta zbatosh.

Z. ministër, ju sigurisht e keni lexuar Raportin e Zyrës së auditorit gjeneral mbi pasqyrat financiare të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2005, ju i keni vërejtur të gjitha ato shkelje të cilat i janë bërë Buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Sikur të kishit vetëm pak përgjegjësi ndaj profesionit, dinjitet ndaj vetvetes dhe përgjegjësi ndaj tatimpaguesve kosovarë, nuk kishi vazhduar më tutje me keqpërdorimin e buxhetit dhe me shkelje të ligjit. Kështu i kishit bërë nder vetvetes, institucionit dhe votave që të kanë sjell aty ku je. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Për AAK-në, Gjylnaze Sylja

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit.

I nderuari z. kryetar, Dëshiroj të ripërsëris dhe të rikonfirmoj edhe një herë qëndrimin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës se ne jemi plotësisht dhe

në përpikëri për zbatimin dhe respektimin e ligjit. Për këtë arsye edhe në Komisionin Hetimor që është ngritur në Kuvendin e Kosovës, ne kemi marrë pjesë dhe kemi dhënë kontributin tonë.

Lidhur me çështjen që e ka shtruar Grupi Parlamentar ORA duke marrë vetëm një pjesë të një konstatimit të Komisionit. Ne konsiderojmë se Ministri e dha përgjigjen, kurse i hedhim poshtë mendimet dhe fjalitë të cilat i tha deputetja Safete Hadergjonaj, se koalicioni është ngritur në interesat individuale që janë **ngritur mbi interesat publike**. Dëshiroj ta rikujtoj deputeten Hadergjonaj se Grupi Parlamentar i Aleancës dhe koalicioni gjithnjë do të jenë të përkushtuar dhe do të përkujdesen për parane publike.

Një ndër prioritetet që i kemi vënë vetes edhe si Grup Parlamentar ka qenë patjetër buxheti dhe pikërisht pse jemi në koalicion e konsiderojmë se është përgjegjësi jona më e madhe se sa e opozitës për të kontrolluar dhe për të bërë atë çka duhet për të kryer punën e vet Qeveria e Kosovës.

Zoti kryetar,

Mendojmë që jo vetëm një pjesë e këtij rekomandimi i Komisionit, por ashtu siç ka vendosur Kuvendi i Kosovës, duhet të zbatohen të gjitha rekomandimet, siç i kemi votuar dhe ne do të japim kontributin tonë në këtë aspekt.

Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA:

Urdhëroni Safete Hadergjonaj, replikë, një minutë e keni.

SAFETE HADERGJONAJ:

Unë e di që koalicioni qeverisës kështu duhet të deklarojë se është duke e respektuar çdo rregull, çdo ligj, mirëpo unë i kisha bërë pyetje zonjës Gjylnaze a është shkelur në këtë rast apo nuk është shkelur? A është shkelur Ligji të transferi i një milion eurove, apo nuk është shkelur? Atëherë kryeministër ka qenë personi nga partia së cilës i takon zona Gjylnaze. Unë dua vetëm një gjë t'ju them: ky koalicion qeverisës e ka personalizuar institucionin dhe po e dëmton, po i dëmton institucionet e Kosovës. Unë do t'ju thosha se këtu vie në shprehje ajo, unë jam i pari dhe bëj çfarë të dua. Mirëpo këtë nuk e lejon ligji prandaj duhet të fillohet të respektohet ligji.

KRYETARI, KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Urdhëroni deputete Sylja

GJYLNAZE SYLA:

Mendoj që do t'i ndihmoj koleges sime nëse i them që nuk jam unë në interpelancë dhe nuk e shoh të arsyeshme t'i përgjigjem. Pra, nuk jam në interpelancë. Ndërsa, sa i

përket çështjes tjetër që përmendi, ajo nuk ishte çështje e shqyrtimit të interpelancës. Mendoj që deputetja u fut në një temë tjetër të cilës mund t'i referohet në të ardhmen. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Enver Hoxhaj – S' është këtu. Xhevat Bislimi

XHEVAT BISLIMI:

Z. kryetar, zotërinj deputetë, për dallim nga grupi ORA unë nuk jam aspak i befashuar në këto shkelje që i ka bërë Qeveria edhe në rastin e blerjes së veturës së blinduar. Unë do të befashohesha sikur kjo Qeveri të bënte ndonjë punë të mirë, të respektonte ndonjëherë procedurat, t'i respektonte ndonjëherë ligjet, por deri tash e dimë sa shkelje janë bërë. E kemi rastin e **hazerilokut** shumë të freskët që ka përfituar gati një milion euro nga buxheti i Kosovës, në mënyrë krejt të paligjshme. Askush deri sot nuk ka dhënë shpjegime për këtë punë, blerja e veturave, shpenzimet për telefon, dhjetëra mijëra euro, qindra mijëra euro brenda vitit, shpenzime për vettura luksoze, tenderët se si bëhet. se si shpallen, humbjet që i ka shkaktuar operatori i dytë i telefonisë mobile në dëm të Buxhetit të Kosovës dhe të operatorit të parë, kështu që nuk jam aspak i befashuar. Unë pres nga kjo Qeveri të vazhdojë, siç tha Gjylnazja me përkushtimin që kishte deri më tash dhe Kosova do të ketë vetëm dëme nga ky përkushtim i Gjylnazës dhe i Gjylnazeve të tjera.

Nuk janë as tri ditë që kjo Qeveri ka ndarë nga Buxheti i Kosovës 75 milion euro plus për Korporatën Energjetike, edhe ato janë para të buxhetit dhe ajo ndarje është krejt e paligjshme dhe...

Ndërhyrje e kryetarit ( përcaktohu për rendin e ditës ju lutem)

na del kryeministri i befashuar me shtrenjtimin e rrymës elektrike. Na thotë se nuk kemi kompetenca aty, kurse paskan kompetencë me ju dhënë miliona euro për çdo vit, dhjetëra miliona, qindra miliona euro kësaj kompanie që i ka shkaktuar gjithë këto dëme Kosovës, konsumatorit, ekonomisë të Kosovës dhe të ardhmes të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA:

Urdhëroni deputete Gjylnaze Sylja

GJYLNAZE SYLA

Ju faleminderit z. kryetar. Unë prita edhe nga parashtuesit edhe nga deputetët që ky të jetë një debat i mirëfilltë dhe jo i personalizuar, jo kundër meje, unë ia them edhe një herë edhe Xhevat Bislimit, i cili vazhdimisht del nga tema e që unë e kuptoj vullnetin e

tij që ai të promovohet brenda seancës. Megjithatë, tema është tjetër dhe interpelanca dihet se cila është tema.  
Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Në emër të Grupit për Integrim,  
Urdhëroni z. Bislim

XHEVAT BISLIMI:

Për t'u promovuar ia kam lënë Gjylnazës se e ka bukur në qef këtë punë. Unë jam këtu për të paraqitur shqetësimet e qytetarëve të Kosovës dhe të zgjedhësve tanë, edhe nuk e thash Gjylnazën me e personalizuar, e shumëzova gjylnazet.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Urdhëroni z. Agani e keni fjalën.

FERID AGANI:

Ju faleminderit z. kryetar, Grupi Parlamentar për Integrim në një mënyrë ka qenë kësaj here i privilegjuar kur është në pyetje kjo çështje, me qenë se e kemi udhëhequr Komisionin Hetimor dhe lidhur me këtë, unë vetëm do të referohem në Raportin përfundimtar të miratuar nga ky Kuvend dhe mendoj se kjo duhet të jetë pikënisja për të gjitha grupet parlamentare me rastin e diskutimit.

Mendoj se diskutimet e përgjithësuara ne jemi për ligj, për respektimin e ligjit, duhet ta respektojmë, do të marrim pjesë. Mendoj se janë të tejkaluara sa i përket kësaj çështjeje, fundi i fundit ai Komision hetimor që ngritur mu për këtë qëllim të ofrojë fakte dhe konkludime konkrete. Unë vetëm po përkujtoj përfundimin 7.4.10 të Raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor, i cili thotë: "Ministria e Ekonomisë dhe e Financave nuk i ka respektuar dispozitat ligjore duke e lejuar pagesën e veturës së blinduar nga vija buxhetore për renovimin e objekteve të Kuvendit". Ky ka qenë përfundim, kjo ka qenë subjekt i shumë diskutimeve, i shqyrtimit të shumë materialeve dhe lidhur me këtë, unë nuk shoh arsye që të hapet debat, së paku jo në këtë Kuvend. Ky përfundim mund të jetë subjekt i analizave profesionale ose i ekspertizave plotësuese, por jo i nivelit politik të diskutimeve. Në bazë të këtij përfundimi është nxjerrë konkludimi që në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave të shqyrtohet përgjegjësia përkitazi me lejimin joligjor të pagesës nga pika 7.4.10 të këtij raporti. Ky është rekomandimi 8.11. Unë nuk e pashë se nga fjala e ministrit një proces i tillë i shqyrtimit të përgjegjësisë ka filluar në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave dhe kjo tashmë më shtyn mua që ta informoj Kuvendin lidhur me disa detaje, që Komisionin Hetimor e kanë shtyer me konstatuar se nuk është respektuar ligji.

Nën një, në formularët të cilët ne i kemi siguruar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave lidhur me procesin e përgatitjes së buxhetit të Kuvendit të Kosovës për vitin

2005, në formularin PCF 4, që janë 4 lloje të formularëve, në formularin PCF 4, ku vijmë të shpenzimet kapitale janë të thyera projektet, janë të definuara, të identifikua projektet veç e veç, do të thotë blera e veturave, konstruktoni i ndërtesave, riparimi i ndërtesave kapitale etj. dhe janë 10 pika në të cilat janë këto projekte të përcaktuara dhe kjo gjë ka qenë mjaft e qartë për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave në atë moment. Për të vërtetuar këtë, Komisioni Hetimor e ka siguruar edhe botimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Ministri mund të shikojë në faqen 40 të këtij botimi, do të thotë buxheti i vitit 2005, në të cilin shumë qartë është e definuar shuma e mjeteve të dedikuara për Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi.

Më tutje, Komisioni e ka pasur materialin zyrtar prej Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, së cilës iu referua edhe deputetja Hadërgjonaj. Pra, dokument i dt. 22. janar 2007, në të cilin, në mes tjerave është parashtruar edhe dokumenti i sekretarit të Kuvendit të Kosovës në të cilin thuhet: që të **bëhet predestinimi** i mjeteve nga mjetet buxhetore për Qendrën Administrative Protokollare në qëllimin për blerjen e veturës së blinduar.

Pra, siç po e shihni Komisioni Hetimor ka konkluduar në bazë të këtyre fakteve se Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka qenë e informuar lidhur me atë se është duke u bërë një riedestinim. Për Komisionin ka qenë, veçanërisht sinjifikante fakti se kërkesa për redestinimin e mjeteve nga ish sekretari i Kuvendit është nënshkruar me 25 nëntor 2005, pagesa e mjeteve është bërë me 25 nëntor 2005 dhe pranimi fiktiv i mallit në Kuvend të Kosovës është bërë me 25 nëntor 2005. Pra këto gjëra janë bërë krejt në të njëjtën kohë. Prandaj, kjo na ka shtyrë që ne të kërkojmë të konstatojmë mosrespektimin e ligjit dhe të shqyrtohet përgjegjësia brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave lidhur me këtë çështje. Dhe unë mendoj se, me qenë se bëhet fjalë për një rekomandim të Kuvendit të Kosovës, që Ministria e Ekonomisë dhe Financave është dashur të ndërmarrë masa më serioze në këtë drejtim.

Ju faleminderit.

#### KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija. Të përgatitet deputeti Bajrush Xhemajli

#### TEUTA SAHATQIJA:

Ju faleminderit z. kryetar. Desha, gjithashtu, ta falënderoj ministrin i cili i është përgjigjur pozitivisht kërkesës për interpelancë edhe mendoj që me një transparencë, me diskutim për këto çështje bëhet forcimi i demokracisë dhe në të vërtetë shkohet deri te sundimi i ligjit.

Të gjithë e dimë raportin e auditorit, të gjithë e dimë Komisionin Hetimor dhe e dimë që ky Kuvend e ka miratuar këtë Komisionin Hetimor, në të cilën konstatohen shkeljet, prandaj a ka shkelje apo nuk ka mendoj që është e tepërt të flitet për këtë, por nuk është e tepërt të flitet për përgjegjësinë ndaj parasë publike, për përgjegjësinë për sundimin e **ligjit** edhe për përgjegjësinë ndaj detyrës së secilit, në këtë rast edhe detyrës të ministrit, sepse prej diskutimit të ministrit e pamë që faji është jetim, që Ministria nuk ka faj. Ministri është zoti i shtëpisë i buxhetit, edhe ministri nuk ka nevojë ai t'i kontrollojë

me mija pagesa apo me mija dokumente, por ministri i ka njerëzit e vet të cilët i kontrollojnë, edhe prej të cilëve kërkon përgjegjësi për ato punë.

Mendoj që këtu flitet për një neglizhencë, për një neglizhencë të përgjegjësisë, për një neglizhencë të ministrit edhe të kontrollit të punës së punëtorëve të vet pa marrë parasysh a është Departamenti i Thesarit, a është ndonjë departament tjetër apo jo. Mendoj që ministri duhet të përgjigjet edhe të kërkojë përgjegjësi prej punëtorëve të vet. Por, nuk është vetëm përgjegjësia e ministrit. Këtu u cek edhe prej tjerëve, pyetja për të cilën kisha pasur dëshirë të dëgjoj prej ministrit: A është folur për këtë çështje në Qeveri? A ka qenë Qeveria e njoftuar për këtë blerje me një pagesë enorme të paligjshme, me një blerje e cila nuk është fare e paraparë në buxhet, me një blerje njëburimore të një veture, me një blerje ku pagesa bëhet në avans, kur e dimë që çdo tender kryhet me ardhjen e pajisjes, atëherë bëhet pagesa dhe më në fund edhe pse ka qenë blerje urgjente, kjo veturë ende sot e kësaj dite nuk ka ardhur. A nuk e meriton kjo një diskutim, a nuk e meriton kjo një kërkesë të përgjegjësisë? A nuk kanë qenë këto të mjaftueshme, a nuk ka qenë një signal për alarm që diçka nuk është duke shkuar në rregull, e këndej dëgjuam që Ministria dhe ministri nuk ka shkelje. Desha të pyes- Çka ka ndërmarrë ministri, çka ka **ndërmarrë** Qeveria? Mendoj që këtyre çështjeve, çështjes së veturës dhe çështjes të Gërmisë duhet t'i jepet një rëndësi jashtëzakonisht e madhe. Nuk janë këto vetëm vetura, nuk janë këto vetëm ndërtesa, vlerat nuk janë aq të rëndësishme sa është i rëndësishëm fakti që, në qoftë se këto zgjidhen në mënyrë si duhet, atëherë kemi një garancë që Kosova do të jetë një shtet ku ka sundim të ligjit jo në mënyrë deklarative, por me vepra, me rezultate. Në qoftë se këto nuk zgjidhen qysh duhet, nuk ka përgjegjësi për shkelje, pa marrë parasysh të kujt, atëherë çfarë shteti do të jetë Kosova, a do të jetë shteti ku sundimi i ligjit do të jetë vetëm nëpër do pankarta, nëpër do letra apo do të jetë vërtet vend ku sundon ligji.

Për përfundim desha të them, që edhe Grupi ynë Parlamentar i bashkohet koalicionit që thotë, që jemi për sundim të ligjit, por mendoj që ky sundim të ligjit duhet të jetë i sinqertë dhe të verifikohet me rezultate jo me deklarata, me rezultate këtu, me rezultate në organet kompetente ta **zgjidhin**, të kemi rezultat që të jemi të sigurt që me të vërtet sundimi i ligjit të mos të jetë veç deklaratë e thatë.  
Ju faleminderit.

#### KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli, të përgatitet deputetja Selvije Halimi

#### BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju faleminderit z kryetar, përshëndetje për ministrat e pranishëm, kolegë deputetë  
Për mua në të vërtetë nuk ka dilemë se a janë bëri shkelje e tjera, por unë mendoj që shkelje ka aq të shumta dhe përpara i ka evidentuar ky Kuvend dhe ka marrë qëndrimen të tjera dhe për këtë mjafton vetëm të thuhet fakti se vetura prej 236.000 nuk dihet ku

është. Mendoj se mjafton dhe është alarmante. Por, mendoj se vetura është puna më e vogël

Unë dua ta ngre këtu me këtë rast, në këtë kontekst një çështje tjetër. Për mua problemi numër një është se nuk funksionon gjyqësori edhe më vjen mirë që është ministri i Drejtësisë këtu z. Salihu. Nuk funksionon gjyqësori për shkak se absolutisht nuk është i pavarur. Dihet që edhe për këtë Kuvend është i njohur, që ka presione të ndryshme, shantazhe etj. që kjo garniturë që aktualisht e përbën gjyqësorin, madje edhe e kuptoj për shkak se është po e njëjta garniturë që ka qenë përpara dhe e cila ka dënuar me porosi njerëz sipas appetiteve të ish- pushtetit dhe meqë janë të njëjtit njerëz është vështirë me i ndërruar sjelljet me përjashtime që natyrisht për ta vërtetuar rregullin e në veçanti për disa të rinj që tash janë aktivizuar, ndoshta është një shpresë se diçka e tillë do të bëhet. E kam fjalën se do të bëhet një reformë në gjyqësorin e Kosovës. Nëse nuk bëhet kjo reformë, atëherë rezultatet e këtyre debateve janë me siguri të zbehta, sepse gjyqësori patjetër duhet të ngritet në nivelin e detyrës siç i takon, përndryshe ky debat dhe shumë debate të tjera që kanë qenë për shkeljet e shumta, pa vepruar gjyqësori, mendoj se i ngjan fort guatjeve të bretkosave në moçal. Ju faleminderit.

#### KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi, të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

#### SELVIQE HALMI:

Ju faleminderit z. kryetar. Na është bërë një rutinë e shprehjeve nga të gjithë njerëzit të cilët bartin përgjegjësi publike dhe institucionale në Kosovë, se kur janë në pyetje inkasimet nga qytetarët, pagesat për tatime apo taksa të ndryshme, themi se duhet të zhvillojnë fushata, të organizojnë takime, seminare për të ngritur vetëdijen e qytetarëve në mënyrë që ata t'iu përgjigjen institucioneve për taksa, tatime dhe inkasime.

Unë kisha me e shtuar pyetjen: A mendon dikush se ndoshta një ditë do të duhet të organizohen takime, trajnime, seminare e gjëra të ndryshme, që ta ngritë vetëdijen e institucioneve të Kosovës e vetë atyre njerëzve që përdorin fraza rutinë se një ditë duhet të fillohet të zbatohet ligji dhe një ditë secili të mendojë se për çdo veprim të bërë duhet të jep llogari, qoftë ai i mirë apo i keq dhe llogaria do të jetë gjithëherë komformë rezultateve që ai tregon në vendin e tij të punës.

Kur ngritet një çështje për diskutim në Kuvendin e Kosovës për informim apo për shqyrtim, nuk duhet ta marrim me shqetësim sepse ajo çështje pavarësisht se nga kush ngritet, nga deputetët, nga Qeveria apo nga grupe qytetarësh të cilët kërkojnë për gjëra të caktuara që duhet diskutuar në Kuvend dhe të vendosë Kuvendi. Ato janë në interes të të gjithëve edhe të koalicionit qeverisës edhe të partive opozitare edhe të vetë qytetarëve, pavarësisht se sa janë të rëndësishme. Mjafton një njeri të ngritë një shqetësim dhe Kuvendi duhet të debatojë logjikshëm, arsyeshëm dhe ligjshëm.

Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, kur bëhet planifikimi buxhetor për të gjitha kërkesat buxhetore, që duhet të hyjnë në Planin buxhetor për një vit jepet një arsyeshmëri, unë kisha me bërë pyetje: A lexohen arsyeshmëritë për kërkesat buxhetore të cilat duhet të planifikohen dhe të hyjnë në buxhet nga personat kompetent në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe mbi bazën e çkafit e vendosin arsyeshmëritë për prioritetet buxhetore. Deri me tash kemi shembuj, sikur që është edhe ky i sodit që diskutohet arsyeshmëria shkon mbi njohtsitë mes tyre, mbi interesat e grupit që kërkon diçka apo mbi lidhjet e tyre dhe interesat e tyre jashtë grupit drejtpërdrejtë qeveritar. Edhe një pyetje të fundit e kam, sepse shumë herë kam deklaruar se ky Kuvend duhet një herë e për gjithmonë t'i vejë pikë diskutimeve për zbatimin e ligjit dhe të diskutoj për çështje të tjera sepse ligjet janë obligative për të gjithë dhe duhet t'i zbatojnë, në rastin e veçantë është Qeveria dhe institucionet tjera lokale. Ajo janë drejtpërdrejtë ekzekutues të ligjit, ne i aprovojmë dhe i mbikëqyrim ato. Kur do të filloj kjo Qeveri që t'i thotë vetvetes se prej sot nuk do të ketë shkelje të ligjeve, nëse kjo nuk bëhet, ne si kuvend, në veçanti koalicioni, Qeveria, por edhe të gjitha institucionet tjera që veprojnë në mënyrë të organizuar e kanë humbur të drejtën që të kërkojnë nga qytetarët që t'iu përgjigjen kërkesave të institucioneve, të kërkojnë nga qytetarët se një ligj është në fuqi edhe eja dëgjo seminar e trajnim se këtë ligj duhet ta zbatosh ti si qytetar i Kosovës. Ju faleminderit.

#### KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Urdhëroni Ministër Salihu (replikë)

#### JONUZ SALIHU, MINISTËR:

Jo që janë të replikuar, por si informatë unë pajtohem me shumicën e zërave që në gjyqësor ka probleme dhe normalisht kërkush nuk ka pritur që problemet e akumuluar në gjyqësor të zgjidhen brenda njëviti të punës të Ministrisë të Drejtësisë. Normalisht, që Ministria e Drejtësisë nuk është e lidhur me gjyqësor dhe ajo është plotësisht pushtet i ndarë. Ajo që është lajm i mirë për Kuvendin dhe për Ministrinë e Drejtësisë, është se së shpejti do të nënshkruhet një memorandum tri palesh mes të BE-së, UNMIK-ut dhe Zyrës Amerikane për një proces të riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo është diçka që të gjithë jemi pajtuar, pra çdo gjyqtar dhe prokuror do të del para një komisioni miks pra të përzier vendor e ndërkombëtar dhe do të përgjigjet për punën e tij, për mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, për aplikimin e standardeve kohore, për shkeljet eventuale, por ju duhet ta diti dhe sigurisht e dini që ne kemi ende për fat të keq probleme me numrin e vogël të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe me numrin e madh të lëndëve. Ne i kemi 421 gjyqtarë dhe prokuror dhe kjo nuk mjafton për një mal të lëndëve që duhet zgjidhur, do të thotë po punohet shumë në këtë drejtim, por Ministria e drejtësisë dhe po ashtu edhe pakoja e Ahtisarit gjyqësorin e ka ndarë plotësisht nga ekzekutivi. Ne nuk kemi asnjë lidhje tani me gjyqësorin sepse sipas pakos Ministri i drejtësisë më nuk do të jetë më as anëtar i Këshillit gjyqësor të Kosovës. Po, politikat e Ministrisë së drejtësisë, aplikim i ligjeve, aprovimi i ligjeve, hartimi i ligjeve, zbatimi është i gjyqësorit, normalisht na e kemi një mekanizëm kontrollit nëpërmes Inspektoratit Gjyqësor të Kosovës, por edhe ai është i pavarur. Edhe ai nuk është nën ambredhën e

Ministrisë të Drejtësisë. Prandaj, unë e di shqetësimin e njerëzve për gjyqësorin, por unë besoj që kanë me ardhur ditë të mira dhe veç janë në prag ditët e mira për gjyqësorin, normalisht na duhet edhe një mbështetje ma e madhe materiale për shkak të pozitës shumë të rëndë të gjyqësorit.

Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit, deputetja

NEKIBE KELMENDI:

Ju faleminderit z. kryetar, Me sa mbaj në mend ky Parlament ka themeluar një Komision Parlamentar për të gjitha gjeturat lidhur me një Raport që e kemi pasur nga auditori i përgjithshëm dhe ai Komision parlamentar ka mbaruar punën e vet me një raport gjithëpërfshirës. Në atë raport ka qenë përfshirë edhe kjo çështje që sot është ngritur. Unë mendoj se proceduralisht sa i përket debatit lidhur me veturën, keqpërdorimet e tjera e tjera, kjo çështje për Parlamentin duhet të konsiderohet si çështje e mbyllur, ndërkaq ne si Grup Parlamentar dhe unë personalisht si anëtare e atij Grupi Parlamentar, mendoj se tani e tutje me këto çështje duhet të merret organi kompetent dhe duhet të veprohet sipas ligjit, dhe konsideroj se nuk është mirë që çdo here kjo çështje të ngritet vetëm të ndërrohen personat se kush do të jetë në shënjestër gjatë debatit. Nëse dikujt nevojitet që gjithmonë të ketë tensione në Parlament dhe nëse dikujt i nevojitet për të bërë ndonjë marketing politik, atëherë nesër mund ta përfshijë ndoshta edhe Sekretarin permanent të Ministrisë të Financave dhe të vjen dhe të jep këtu përgjigje lidhur me veturat.

Ju them se tash kjo çështje proceduralisht sa i përket debatit është e mbyllur, për ne nuk është çështje e mbyllur sa i përket përgjegjësisë tjera, sepse me to do të merret ligji dhe do të merren organet kompetente siç është Prokurorja dhe gjyqësori. Por, duhet ta dimë se është diskutuar dhe është pjesë e raportit gjithëpërfshirës të Komisionit të themeluar nga ky Kuvend.

Ju faleminderit.

KRYETAR KOLË BERISHA:

Ju faleminderit, Z. Ministër keni diçka?

HAKI SHATRI, MINISTËR:

Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.

Unë po i përsërisë procedurat për pagesa brenda organizatave buxhetore janë për përgjegjësi e autoriteteve brenda organizatave buxhetore. Na nuk mundemi të paragjykojmë parregullsi. Nëpunësit e Thesarit nuk mund të paragjykojnë parregullsi në një dokument që vjen nga një organizatë buxhetore, e cila do qoftë dhe të thotë: ndal të kujtona unë njëherë se se di a është kjo sahi a nuk është, a çka është. Na e kemi personin e autorizuar zyrtar dhe ai e ka përgjegjësinë nëse një veprim brenda organizatës

buxhetore është bërë sipas dispozitave të ligjit apo nuk është bërë. Ju i keni parashtuar çështjet, zonja Hadergjonaj i keni shtruar në diskutim para se me dëgjuar prezantimin tim. Është një prezantim që pjesërisht e dëgjoj që nga 5 herë prej se jam ministër dhe nuk ka të bëjë fare me çështjen që është shtuar për interpelancë, por një akuzë e përgjithshme për Qeveri, për pa rregullsitë e tjera që më tepër ka karakter të një natyre fushate parazgjedhore se sa lidhur me çështjen konkrete që po diskutojmë. Them edhe një herë, nëse nuk i kuptoni aktet normative, Urdhëresën administrative apo nuk doni ta kuptoni, kjo është çështje juaja, por është obligim që të flasim me përgjegjësi përpara këtij auditoriumi dhe para opinionit, sepse kjo, siç duket, për shkak transmetohet publikisht njerëzit ndiejnë nevojë që t'i përsërisin këto gjëra, që janë thënë edhe në rastin e diskutimit siç tha deputetja Kelmendi në rastin kur ka qenë në diskutim çështja e Raportit të auditorit për të gjeturat në Kuvendin e Kosovës

Z. Bislimi, të kisha lutur, nuk është këtu por, sigurisht e përcjell mos ta dezinformoj opinionin për kinse ndarjen e 75 milionë euro për KEK-un. Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për mundësinë e kreditimit, **një kredie të butë** për të filluar puna në eliminimin e avarive në eskavatorin 2 dhe 3 dhe nuk janë ndarë mjete buxhetore. Është një huazim i përkohshëm, i cili bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe ju lutem mos ta shfrytëzojmë Kuvendin për të dezinformuar opinionin për nevoja personale apo të subjektit politik.

Qeveria e ka sjellë situatën, i tregoj rezultatet e Qeverisë. Ajo me punën e vet në këtë mandat ka punuar në atë mënyrë që është vlerësuar pozitivisht nga të gjitha strukturat dhe faktori ndërkombëtar relevant deri te Këshilli i Sigurimit dhe si rezultat i punës së Qeverisë ka filluar dhe po përfundon procesi i definimit të statusit të Kosovës pra, po dihet pavarësia e Kosovës dhe argument tjetër, unë nuk dëshiroj t'ju sjellë para jush për çështjet e rëndësisë së Qeverisë. Ju lutem e keni akuzuar Qeverinë, unë jam anëtar i Qeverisë dhe kam drejtë ta promovojë. z. Agani .Ju faleminderit shume, keni qenë korrekt edhe gjatë mandatit si kryesues i Komisionit Hetimor edhe në prezantim, dhe ju them që, ka elemente por nuk janë të ndara në përgjegjësi, sepse po ju përsërisë edhe një here deri në fund të vitit 2005 përgjegjësinë për ta ndërruar destinimin e mjeteve ka pasur organizata buxhetore. Ju e dini fare mirë që Kryesia e Kuvendit e ka kompetencën për të vendosur për buxhetin e vet Kuvendit. Mirëpo, për investimet kapitale nga vitit 2006 e këndej pa një procedurë të rregullt as Kryesia e Kuvendit nuk mundet me e nderuar destinimin për projektet individuale, sepse kanë ndërruar rregullat. Nëse auditori gjeneral, zonja Sahatqija, nëse auditori gjeneral konstaton shkelje të atij niveli që kërkon masa, atëherë auditori gjeneral nis procedurat për përgjegjësi konkrete qoftë në Ministrinë e Financiare, qoftë në Kuvend ose në organizatat tjera buxhetore. Qeveria nuk e ka diskutuar asnjëherë a me ble kryetari i Kuvendit veturë apo mos me ble, nuk është punë e Qeverisë me diskutua çështjen e veturës ose të cilës do veturë që blihet në cilëndo organizatë buxhetore.

Te masat, shkalla e pestë e përgjegjësisë ka filluar prej vitit 2006 dhe nuk mund të kthehet retroaktivisht dhe të ndëshkohet dikush për një masë, për një rregull e cila në vitin kur është bërë, në kohën kur është bërë nuk ka qenë në fuqi.

Z. Xhemajli e ka përsëritur një diskutim që kohë më parë është mbajtur në Kuvend dhe besoj, siç tha zonja Kelmendi nuk ka nevojë që të përsëritet vetëm sa për opinion. Arsyeshmëria e kërkesave buxhetore, kur shtrohen kërkesat buxhetore për vitin e ardhshëm buxhetor, çdo organizatë buxhetore e parashtron një varg të tërë kërkesash për projekte buxhetore me parallogarit dhe ju them me përgjegjësi procedura e përgatitjes të buxhetit nuk zgjatë një javë, as nuk e vendos as ministri e as Departamenti i Buxhetit, fillon në muajin shkurt dhe përfundon në ditën kur miratohet në Kuvend. Unë ju them me përgjegjësi se këto procedurat e dëgjimeve buxhetore zgjasin dy muaj më së paku dhe marrin pjesë të gjitha subjektet e interesuara, duke përfshirë këtu edhe Komisionin për Buxhet të këtij Kuvendi dhe ajo që është më me rëndësi, pra vetë dokumenti i buxhetit ju ka sjell Kuvendit në muajin nëntor dhe ka pasur minimum afat një muaj që të diskutohet. E di që bashkë me dokumentin Kuvendit dhe të komisioneve përkatëse ju kanë sjellë të gjitha kërkesat e organizatave buxhetore, ato kanë pasur mundësi me i pa se cilat janë e cilat nuk janë, dhe Kuvendi ka pasur mundësi me i ndërruar prioritetet në qoftë se e ka siguruar shumicën e votave në këtë kuvend dhe në fund zonja Kelmendit faleminderit për korrekti dhe përmbajtje.

#### KRETARI KOLE BERISHA:

Deputetja Safete Hadergjonaj – replikë

#### SAFETE HADERGJONAJ:

Ju faleminderit z. kryetar. Këto argumente, të cilat i tha sot ministri në faktikisht, unë i kam pasur këto, sepse kam qenë anëtare e Komisionit hetimor dhe kam pasur rastin t'i shoh edhe aty, prandaj edhe ka ardhur deri te ai rekomandim, me qenë se të gjithë anëtarët i kemi pas para veti dhe kemi rekomanduar ashtu siç ka ardhur në raportin të cilin e kemi përfundimtarin. Nëse ju z. ministër i konsideroni argumente këto që ju i thatë, unë me plot gojën do të kisha thënë nuk e meritoni me qenë ministër, sepse jam përpjekur ta kuptoj ligjin, ta lexoj dhe ta kuptoj, por njëkohësisht edhe udhëzimet të cilat janë nxjerrë nga Ministria e juaj. Unë do të kisha thënë edhe gjë mbrojtja e ligjit nuk është fushatë, debati për ta respektuar ligjin nuk është fushatë dhe nëse sot nuk po vepron ligji z. ministër, të jeni i vetëdijshëm se në të ardhmen do të veproj ligji, sepse jemi në përpjekje e sipër ta ndërtojmë shtetin e Kosovës.

Ju faleminderit.

#### KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Xhavit Haliti, mir

Bajrush Xhemajli, replikë

#### BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju faleminderit z. kryetar. Unë e kuptoj z. ministër që është në siklet, por të mos mërzhitet shumë se gjysmë ore ashtu nuk vepron, nuk e ka ndërmend me veprua se ka presion të madh **prej ministrit e bashkë kolegëve të tij. Po unë nuk di kur jam përsërisë** nuk e besoj asnjëherë së paku veç që e kam përsëritur një gjë të tillë, por nëse nuk ndëshkohet keqpërdoruesi i buxhetit siç është rasti me veturën që ky, në përgjigjen kryesore ti nuk ke thënë kurgjo, në pyetjen kryesore, ku është vetura? Ti nuk po e di ku

është vetura 230 e kusur mijë euroh e tash me kallëzon mua jo kështu jo ashtu. Ti çohu dhe trego ku është vetura, ku të ka shkuar i ke dhënë sa para, edhe nëse nuk ndëshkohen këto çështje çdo ditë duhet me përsëritë z. Ministër, çdo ditë e unë hera e parë që po e them, por kjo le të mbetet te ti.

#### KRYETARI KOLË BERISHA:

Urdhëroni z. Bislimi

#### XHEVAT BISLIMI:

z. Ministër nëse është dezinformatë apo nuk është dezinformatë këtë do ta vlerësoj qytetari i ynë se kush po e dezinformon qytetarin, kush po e mashtron, kush po e gënjen dhe kush po e vjedh për çdo ditë paranë e tij, buxhetin e tij këtë e vlerëson qytetari. Nëse është dezinformatë apo jo e vlerësojnë ata që po rrinë në terr përditë dhe ju po i kërkon para nga xhepi i tij drejtpërdrejt edhe nga taksa e tij po i jepni KEK-ut. KEK-u po paguhet dy herë - tri herë për atë që po ia bën qytetarit të Kosovës, për dëmet që po ia shkakton Kosovës, ju po e shpërbleni. Vazhdoni ta shpërbleni deri sa të jeni në Qeveri!

#### KRYETARI KOLË BERISHA:

Urdhëroni z. Haliti

#### XHAVIT HALITI:

Unë me shqetësim po i përcjell që disa seanca, qëndrimet e disa deputetëve në emër të mbrojtjes së ligjit dhe në anën tjetër kërkojnë të mos veprojnë ligji. Në qoftë se janë konstatuar shkelje ligjore, unë mendoj që dikujt i takon ta marrë iniciativën dhe ta dorëzojë dokumentacionin me shkeljet ligjore që janë bërë pa marrë parasysh për cilën çështje është fjala. Ky kuvend ka ngarkuar Komision, ky kuvend ka debatuar, konstatimet janë dhe tani nuk e di se si do të veprojnë më tutje, por mendoj që të gjitha faktet janë që ka shkelje të ligjit.

Jam i shqetësuar edhe për një fakt që qoftë në këtë rast deputet i opozitës janë shumë të zëshëm në mbrojtjen e pasurisë publike. Unë nuk e besoj se është kështu dhe unë dua të shpreh shqetësimin tim që pasurinë publike po e manipulon mafia ekonomike dhe politike e Kosovës dhe ky është një realitet i përditshëm në Kosovë dhe se ky shqetësim, mendoj që do të duhej ta ndajnë me të gjithë ata që në ndërdijen e tyre janë dakord dhe nuk guxojnë, të themi për shkak të qëndrimeve politike në grupet e tyre parlamentare dhe më tutje dhe me të gjithë ata që i shqetëson vërtet keqpërdorimi i pasurisë publike dhe dhënia e pasurisë publike në duart e atyre që të jeni të sigurt që do të jenë në gjendje në të ardhmen t'ua japin deputetëve të Kuvendit të Kosovës rrogat më të mëdha se buxheti i Kosovës dhe dihet atëherë çka mund të ndodhë.

Një pyetje shtesë e kam për ministrin. Z. Ministër u thatë se kryetarët, Kryesia e Kuvendit ka marrë vendim, unë dua ta përsërisë se Kryesia e Kuvendit nuk ka vendim për këtë çështje, sepse me Rregullore Kryesia e Kuvendit nuk ka kompetenca të merre

vendim për menaxhimin e buxhetit dhe s' ka pasur kompetenca. Është e zeza në të bardhë e shkruar dhe e ke lexu dhe kisha si pyetje: a keni gjetur ndonjë dokument dikund që ka marrë Kryesia e Kuvendit një vendim të tillë, qoftë për blerjen e veturave, blerjen e veturës në këtë rast me qenë se po diskutohet, qoftë në çështjet tjera të cilat janë ngritur më herët. Prandaj, në qoftë se duhet, që për interesa politike të debatojmë për çështje të caktuara, atëherë ju kisha lutur që të mos spekuloni në emër dhe në emër të Kryesisë së Kuvendi të Kosovës dhe të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit.  
Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit. Ki përgjigje. Urdhëro

HAKI SHATRI:

Faleminderit, z. Haliti unë e konsideroj mjaft korrekt qëndrimin tuaj, por në fund të paraqitjes sime thashë: unë jam i gatshëm me u përgjegjë për gjërat, procedurat që i kanë bërë ministri i Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Departamenti i Thesarit dhe se jam përkufizuar qysh në fillim. **Nuk i**

MINISTRI HAKI SHATRI:

Jam i gatshëm të debatoj për veprimet që janë bërë në organizatën buxhetore në këtë rast, në Kuvendin e Kosovës. Kam qenë mjaft i qartë dhe thashë sipas ligjit, sipas Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit është kompetente për të vendosë për buxhetin e Kuvendit, jo për buxhetet e tjera. Unë e di çështje tjetër është ajo se a ka marrë vendim Kryesia e Kuvendit, Thesarit i ka ardhur një shkresë nga personi kompetent i Kuvendit, sekretari permanent i Kuvendit dhe na nuk kemi të drejtë ta vejmë në dyshim a është ai dokument valid edhe të kërkojmë procesverbalin e Kryesisë së Kuvendit, etj. Kjo është çështje e vetë-organizatës buxhetore dhe le ta kërkojnë, ju lutem mos, t'i ndajmë gjëra dhe të jemi të qartë,

Ju faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit, zoti Haliti

XHAVIT HALITI:

Unë mendoj që askush, askund në botë, meqë asnjë vendim nuk është i obliguar ta zbatojë në qoftë se ky vendim nuk është i mbështetur në ligj.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit, propozuesi i interpelancës, nëse ka diçka, i keni në disponim 5 minuta.

NAZIM JASHARI:

I nderuari kryetar, zoti ministër, të nderuar kolegë deputetë,

Mos e mendoni se Grupi Parlamentar ORA, dikush e tha që e pasur iluzion që në këtë shoqëri tonën, funksionojnë ligji dhe rendi, nuk e kemi asnjë iluzion, po pikërisht pse nuk e kemi atë iluzion. Ne jemi shumë luftëtarë të mëdhenj që këtë ta bëjmë realitet dhe ajo nuk mund të bëhet realitet, me mbrojtje të këtilla, çfarë parashtroi para nesh këtu ministri, lidhur me diçka që as nuk mund të debatohet më. Unë e thashë edhe në fillim të fjalës sime, pikërisht duke pasur njëfarë intuitede se, në ç'vijë do të përpiqet të mbrohet ministri, thashë që nuk ka marrë masa ndaj asnjë zyrtari lidhur me shkeljet, është ky shkelësi dhe thashë që po ashtu thuhet në nenin 27 të ligjit për menaxhimin e financave publike, që është bashkë me ligjin për buxhet, janë Kurani, Bibla e ministrit Haki Shatri.

Nuk ka tjetër dokument me të cilën zoti Shatri e ushtron funksionin e vet si ministër, në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, siç nuk ka për ministrat e tjerë që, fatkeqësisht shpeshherë po na dalin në foltore dhe po na paraqiten si njerëz të cilët nuk **kanë kompetencë**.

Të nderuar kolegë deputetë!

Ministri është kulmi i pushtetit në një shoqëri, më lart se ministri pushtet nuk ka, edhe ministri, thashë për një fushë-veprimtari. Edhe ministri pak më herët Gjini tha që, Ministria nuk është ajo e vetmja që na duhet me e **mbrojt** rendin e ditës. Më herët e kemi zotin Qemajl Ahmeti, te diskutimi për ART-në, ku **i lante duart** prej përgjegjësisë së vartësve të tij dhe tash e kemi zotin Shatri, i cili thotë që, nuk është ministria gjithçka, pra nuk është Ministria përgjegjëse për shkeljet që bëhen në Kuvend.

Edhe ministri i Kulturës, nuk është përgjegjës për shkeljet në kulturë, sepse ka të tjerë që janë më përgjegjës se këta. Vijnë te një situatë absurde, ose ministrat tonë janë injorantë dhe nuk e dinë përgjegjësinë e vetë, të zbatuar me ligj dhe ligji, të nderuar kolegë deputetë, nuk është kanun, që mund të interpretohet prej goje në gojë, ligji është një akt i shkruar, edhe i publikuar dhe i botuar, ku çdo fjalë është e precizuar qartë dhe thotë:

Nëse ndonjë zyrtar publik apo nëpunës publik, me qëllim dështon, apo më shumë se një herë dështon me neglizhencë, pra ka mundësi me dështim, ka mundësi me neglizhencë, t'u bindet një apo më tepër obligimeve që dalin nga ligji, personi i tillë do të jetë subjekt i një dënimi administrativ deri në 10.000 €. Nëse një dështim i tillë i qëllimshëm, i shkakton dëme, një organizate buxhetore dhe humbje të parave publike, zyrtari i tillë publik apo shërbyesi civil, do të jetë përgjegjës për të gjitha dëmtimet apo humbjet e tilla.

Nëse një dëmtim i tillë, dështim i tillë, përfshinë sjelljet që konsiderohen si një krim nën ligjet dhe rregulloret e përgjithshme penale në Kosovë, personi i tillë gjithashtu do të jetë subjekt i ndjekjes penale sipas ligjeve dhe rregulloreve të tilla. Kjo është e shkruar e zeza në të bardhë dhe këtu nuk ka mundësi interpretimi, interpretimi këtu e bën vetëm ai që është i thirrur për ta interpretuar. Në këtë rast jemi ne si Kuvend, për aspektin politik të përgjegjësisë edhe është gjykata për aspektin ligjor të përgjegjësisë, aspektin penal të përgjegjësisë.

Për aspektin politik të përgjegjësisë nuk ka kush tjetër, po unë po ashtu në fjalën time të hyrjes thashë: po qe se ne, si opozitë do të kishim dorë me e rregullua funksionimin e rendit dhe të ligjit në Kosovë, ne do ta kishim bërë, po shtruar interpelanca, por derisa jeni ju ata që e keni, sepse keni shumicën parlamentare, përgjegjësia është juaja edhe marrja në mbrojtje, e shkelësve të ligjit është po ashtu përgjegjësi juaja. Qytetarët duhet ta dinë, ne po bëjmë politikë edhe do të bëjmë politikë, do të përpiqemi t'ua sqarojmë të gjithëve që kjo mazhurancë e cila udhëheq Qeverinë në Kosovë, është një mazhurancë e papërgjegjshme, siç janë ministrat të përgjegjshëm, nuk mund të jetë as ndryshe. Përdërisa ky ministri mbrapa vazhdimisht lëshon fjalë, se nuk i pëlqejnë fjalët e mija, sigurisht që nuk i pëlqejnë fjalët e mija, sigurisht që nuk i pëlqejnë fjalët e mija, sepse unë para qytetarëve po e paraqes situatën etë cilën të gjithë ata e shohin dhe të gjithë e prekin me dorën e vet dhe e shohin përditë me sytë e vetë, se kur është puna te favorët, te të mirat, tek ato benifitet që i gëzojnë zyrtarët tanë, nga ana e ligjit ata të gjithat t'i shfrytëzojnë deri në maksimum, por kur është çështja për të dhënë përgjegjësi, për zbatimin e ligjit, të gjithë bëhen këtu injorantë, e luajnë anglezin, edhe bëhen që nuk po marrin vesh dhe nuk po kuptojnë çka është përgjegjësia.

Gjërat janë shumë të qarta, anglezët nuk janë injorantë, po shprehja e bën anglezin në kuptimin e, ne e dimë zotin Hamiti çka do të thotë fjala të bëhesh anglez, **hipotekstet** e tjera jashtë Anglisë, prandaj mendoj se nuk e kam asnjë iluzion që ju do të veproni në drejtim të përgjegjësisë .

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit, ministri Gjini e ka fjalën,

MINISTRI ARDIAN GJINI:

Mendoj se është e domosdoshme me e marr fjalën, pas fjalës së deputetit të nderuar, më duhet me e përsëritë jo për ju, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, se e di që shumica dërmuese prej jush, mos me thënë të gjithë, përpos zotit Jashari e keni të qartë, cila është varësia në Kosovë dhe e keni të qartë që prej kësaj foltore, të paktën prej Qeverisë nuk dalin fjalë, si injorancë etj. po dua t'ju tregoj diçka, çka është injoranca,

Injoranca është mos me kuptua që kryetarët e komunave dhe strukturat komunale nuk janë vartëse tonat, bile as tuajat, është injorancë mos me e kuptua që sot në Kosovë, që policia nuk është vartëse jona, është prapë injorancë mos me e kuptua që gjykatat, janë pushtet i ndarë dhe nuk janë vartëse tonat, kjo është injoranca të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe nuk është injorancë me dalë me tregua se cila është varësia.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit, deputeti Alush Gashi e ka fjalën.

ALUSH GASHI:

I nderuari zoti kryetar i Kuvendit,

Ne si grup parlamentar edhe fatmirësisht, si shumicë, me respekt dhe përkushtim të plotë, të respektimit të ligjit, e kemi mbështetur këtë pikë të rendit të ditës, sipas Rregullores së punës së Kuvendit ,zoti kryetar. Unë shpresoj se ju do të kërkonit distancim nga ky fjalor i cili sot përdoret këtu, me quajt deputet injorant, me i quajt ministrat injorant, me i quajt anglezët injorantë, mendoj se nuk është mirë.

Prandaj kërkojmë nga Ju zoti kryetar që, karshi Rregullores së punës së Kuvendit, këto fjalë kaq të liga të hiqen, e rikonfirmoj edhe një herë përcaktimin tonë, për transparencë të plotë, ne nuk jemi shumicë e papërgjegjshme, por natyrisht të mos ju vie keq, na do të jemi shumicë një kohë të gjatë,

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA:

**Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti**

Urdhëro zoti Jashari, urdhëro merre fjalën

NAZIM JASHARI:

Zoti Gjini, qytetarët e Kosovës e dinë që Kosova i ka pesëmbëdhjetë ministri e nuk e dinë që i ka 45 ministri.

Pra në qoftë se ju dilni e këtu thoni që, pushteti komunal nuk është në varësi të ministrave, unë nuk di çka të them, kush është injoranti këtu. Kjo është sa iu përket juve, Sa i përket zotit Gashi, unë nuk ju thashë deputetëve injorantë, ju thashë, atyre që nuk i dinë përgjegjësitë e veta me ligj, injorantë. E tash nëse ju i merrni në mbrojtje injorantët nuk di çka t' ju them juve.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ju faleminderit, fjala injorancë duhet të hiqet nga procesverbali. Urdhëroni zoti Hamiti,

SABRI HAMITI:

Meqë më thirre se, mbas fjalës së zotëri Alush Gashit, pak a shumë tema që doja të flitja vërejtjet e mira u thanë, megjithatë unë duhet të theksoj edhe një herë që, fjalët e mëdha kanë filluar të shqiptohen në Parlament, si kudo në retorikë, që ndodhë se ky është vend ku flitet, atëherë kur po humbet substanca dhe kjo ndodhë në çdo shoqëri, ka filluar të ndodhë në këtë Parlament.

Kur mungojnë argumentet, fjalët rriten. Është mirë kolegë të nderuar, të gjitha grupeve parlamentare dhe individë, t'i ktheheni substancës, materies në mënyrë që të kurseheni nga fjalët tepër të mëdha. Mua nuk më vjen mirë hiq, që kolegu im Xhavit Haliti, për të cilin kam respekt dhe bashkëpunim të mirë në Kuvend, i tha dy fjalë tepër të rënda, mafia politike dhe ekonomike.

Kur thuhet ky formulim në Kuvend, nga kreu i Kuvendit, ku bëj pjesë edhe unë vetë, unë mendoj që është përgjegjësi e madhe së paku të obligon me lëvizë që nga ky moment, në shqyrtimin e këtij formulimi. Unë po them në këtë formulim, **pati këtu** edhe fjalë të tjera të papeshuara, po unë në zjarrin e bisedës ku nuk ka argumente, ose hynë emocionet ose mbetet krejt thatë, kjo po ndodhë edhe në Kuvend. Unë po them edhe një

herë kërkoj një sjellje racionale sa të jetë e mundur, të mos jepen formulime të mëdha, sepse nuk është mirë, pastaj është pak si vështirë që të diskutohen racionalisht.  
Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERISHA:**

Ju faleminderit, Xhavit Haliti e ka fjalën  
Replikë 1, minut

**XHAVIT HALITI:**

Jam shumë i bindur që parafolësi im e di shumë mirë, a ka apo nuk ka mafi politike dhe ekonomike në Kosovë.

Jam shumë i bindur që një pjesë e madhe e dinë atë, e dinë adresën dhe e dinë ku e ka burimin dhe e dinë pse ky Parlament është kaq inert, sepse ka fillua të na i bllokojë këmbët, duart dhe të na e mbyllë gojën, pikërisht kjo.

Prandaj ju kisha lutë që, në qoftë se doni t'i hapim kartat, i hapim në seancë plenare para popullit, para publikut dhe këto karta, pastaj do t'i kenë pasojat e veta, besoj të mira për ta ndërprerë këtë praktikë, që është duke u bërë në Kosovë. Nuk do shumë analizë kjo punë, e kemi përpara, e dimë qysh funksionon praktika e tenderimeve, e dimë qysh funksionon pra praktika e privatizimit, i dimë lojërat që bëhen me këto çështje dhe këtu e kam fjalën, dimë qysh funksionon Agjencioni Kosovar, tash janë bërë shumë agjenci i cili i miraton tenderët, të gjitha këto dihen, nuk donë as ndonjë shkollë as, le të dihen njerëzit që fitojnë këto, le të dihen njerëzit që i mbështesin,

**KRYETARI KOLË BERISHA:**

Ju lutem! Urdhëroni zoti Hamiti, (replikë)

**SABRI HAMITI:**

E tash është fantastike situata, Xhavit Haliti deklaroi publikisht para Kuvendit dhe shoqërisë së nderuar kosovare që, ai e di çka di unë, kjo është fantastike, nëse ky e ka atë aftësi bravo i qoftë, unë për veti nuk e di çka di Xhavit Haliti, prandaj e thërras publikisht në Kuvend dhe kudo ku është përfaqësues të thotë çka di, nëse thotë që do t'i hapë kartat, që është krejt një figurë jo-substanciale dhe thotë dihen, unë po them që variantet neutrale dihen, nuk thonë bash asgjë dhe një përfaqësues nëse i di është i obliguar edhe t'i thotë.

A çka di unë, ai po e dika, e unë besoj që nuk e di.  
Ju faleminderit!

Kalon amendamenti

Ju faleminderit, ju ftoj ta përmbylлим këtë debat dhe të marrim pauzë deri në orën 14 .  
Shefat e grupeve parlamentare le të vijnë në zyrën time 5. minuta.

PAS PAUZE:

Meqë në sallë janë 61 deputetë konsideroj se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë, Duke pasur parasysh se në fillim të seancës nuk isha këtu, përndryshe unë e kam përgatitë një deklaratë në emër të Kuvendit të Kosovës për Rezolutën e parametrat Evropian.

Me lejen tuaj e kisha lexua këtë deklaratë>

#### Deklarata e Parlamentit Evropian

Kuvendi i Kosovës, përshëndet miratimin e Rezolutës së Parlamentit Evropian, në të cilën thuhet se sovraniteti i mbikëqyrur nga Bashkësia ndërkombëtare, është zgjidhja më e mirë për Kosovën. Rezoluta përkrah fuqimisht planin e zotit Ahtisari.

Parlamenti Evropian, në këtë mënyrë, ka bërë veprimin e duhur në momentin krucial, për procesin e përcaktimit të statusit të Kosovës. Vlera e kësaj rezolute është e shumëfishtë. Rezoluta është e rëndësishme për përmbajtjen e saj dhe ajo dëshmoi, kurajën e Parlamentit Evropian, që të kërkojë në mënyrë të qartë pavarësinë e Kosovës. Rezoluta ka peshën e vet edhe për mënyrën se si u miratua. Pra me shumicë dërmuese votash, duke dëshmuar kështu unitetin evropian, si zë i fuqishëm për finalizimin e procesit, lidhur me statusin e Kosovës, në Këshillin e Sigurimit, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Mbështetja e pavarësisë së Kosovës, nga Parlamenti Evropian, është hap i rëndësishëm i përshpejtimit të zgjidhjes së statusit të Kosovës, dëshmi e përgjegjësisë së institucioneve të Unionit Evropian, për Kosovën, por edhe si impuls i ri për integrimin e Kosovës në UE.

A pajtoheni me këtë deklaratë?

( Duartrokitje )

Ju faleminderit,

Kalojmë në pikën e radhës, pikën 5. të rendit të ditës,

#### **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma**

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 9 tetor 2006. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur, raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision Funkcional dhe raportues, në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve, në tekstin e Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma, si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, ka vlerësuar se, Projektligji për mbrojtjen nga zhurma, e ka bazën e vet juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma dhe amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit, për mbrojtjen nga zhurma dhe amendamentet e propozuara, nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Andaj propozoj të shkojmë në aprovimin e amendamenteve të propozuara.

#### AMENDAMENTI NR. 1.

Në sallë janë 68 deputetë

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 57 |
| Kundër.....   | 1  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 57 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

#### AMENDAMENTI NR. 2.

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 63 |
| Kundër.....   | 0  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 63 vota për dhe 0 kundër kalon amendamenti

#### AMENDAMENTI NR 3.

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 60 |
| Kundër.....   | 1  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 60 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

#### AMENDAMENTI NR 4.

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 58 |
| Kundër.....   | 2  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 58 vota për dhe 2 kundër kalon amendamenti

#### AMENDAMENTI NR 5.

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 57 |
| Kundër.....   | 2  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 57 vota për dhe 2 kundër kalon amendamenti

#### AMENDAMENTI NR 6.

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 58 |
| Kundër.....   | 4  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 58 vota për dhe 4 kundër kalon amendamenti

#### AMENDAMENTI NR 7.

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 58 |
| Kundër.....   | 1  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 58 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

#### AMENDAMENTI NR 8.

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 54 |
| Kundër.....   | 2  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 54 vota për dhe 2 kundër kalon amendamenti

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim të Projektligjit në tërësi bashkë me amendamentet e amendamentuara.

Në sallë janë 71 deputetë

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 51 |
| Kundër.....   | 1  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 51. vota për dhe 1 kundër aprohet Ligji për mbrojtjen nga zhurma.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë pika e 6 e rendit të ditës.

#### 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bletarinë

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 14. dhjetor 2006, Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë propozuar raportin e rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raportit të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision funksional dhe raportues në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për bletari si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për bletarinë ka bazën e vetë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për bletarinë dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Ineresat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për bletarinë dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat e interesat e komuniteteve.

Propozoj që të kalojnë në aprovimin e amendamenteve një nga një.

#### AMENDAMENTI NR 1.

Votojmë tash:

Për.....63

Kundër.....1

Abstenim.....0

Me 63 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

#### AMENDAMENTI NR 2.

Votojmë tash:

Për.....59

Kundër.....1

Abstenim.....0

Me 59 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

### AMENDAMENTI NR 3.

Votojmë tash:

Për.....63  
Kundër.....3  
Abstenim.....0

Me 63 vota për dhe 3 kundër kalon amendamenti

### AMENDAMENTI NR 4.

Votojmë tash:

Për.....61  
Kundër.....1  
Abstenim.....0

Me 61 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

### AMENDAMENTI NR 5.

Votojmë tash:

Për.....64  
Kundër.....1  
Abstenim.....0

Me 64 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

### AMENDAMENTI NR 6.

Votojmë tash:

Për.....60  
Kundër.....0  
Abstenim.....0

Me 60 vota për dhe 0 kundër kalon amendamenti

### AMENDAMENTI NR 7.

Votojmë tash:

Për.....65  
Kundër.....4  
Abstenim.....0

Me 65 vota për dhe 4 kundër kalon amendamenti

AMENDAMENTI NR 8.

Votojmë tash:

Për.....63

Kundër.....0

Abstenim.....0

Me 63 vota për dhe 0 kundër kalon amendamenti

AMENDAMENTI NR 9.

Votojmë tash:

Për.....68

Kundër.....1

Abstenim.....0

Me 68 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

AMENDAMENTI NR 10.

Votojmë tash:

Për.....64

Kundër.....1

Abstenim.....0

Me 64 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

AMENDAMENTI NR 11.

Votojmë tash:

Për.....69

Kundër.....1

Abstenim.....0

Me 69 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

AMENDAMENTI NR 12.

Votojmë tash:

Për.....65

Kundër.....2

Abstenim.....0

Me 65 vota për dhe 2 kundër kalon amendamenti

### AMENDAMENTI NR 13.

Votojmë tash:

(ndërhyrje)

Deputetja Lumnije Hyseni e ka fjalën

LUMNIJE HYSENI:

Zoti kryetar. Kam vërejtje te amendamenti nr. 13. Ky përmirësimi që është bërë shkruan pogaçja prej dylli, ndërsa, pogaçja është një përbërës i cili shërben për ushqimin e bletëve dhe nuk ka as përqindjen më të vogël të dyllit, prandaj unë propozoj që ky amendament të mos votohet.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Ne votuam për të,

(Ndërhyrje) Lumnija,

Jo 13. është amendamenti që do të jetë në radhë.

E kam fjalën për amendamentin 13. nuk vlen ky amendament, nuk është i drejtë.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Nga Komisioni, zoti Berat Luza e ka fjalën

BERAT LUZHA:

Zoti kryetar. Kjo është përdorur drejtë, se gjithë e dimë që ka pogaçe të dyllit, është në formën e një pogaçeje, është forma, tregon ajo, unë kam vërejtje ndoshta te përdorimi i fjalës pogaçe, mund të gjendet një term shqip, po nuk e kemi gjetur një fjalë, do të thotë e ka formën e bukës, në atë drejtim.

KRYETARI KOLË BERISHA:

Është votuar ky amendament dhe shkojmë më tutje

E përsërisim amendamentin 13 për shkak se nuk i kemi rezultatet

Votojmë tash:

|               |    |
|---------------|----|
| Për.....      | 43 |
| Kundër.....   | 1  |
| Abstenim..... | 0  |

Me 43 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

AMENDAMENTI NR 14.

Votojmë tash:

Për.....60

Kundër.....2

Abstenim.....0

Me 60 vota për dhe 2 kundër kalon amendamenti

AMENDAMENTI NR 15.

dhe i fundit

Votojmë tash:

Për.....59

Kundër.....1

Abstenim.....0

Me 59 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti

Lus regjinë dhe deputetët të votojmë për tekstin në tërësi bashkë me amendamentet e aprovuara.

Votojmë tash:

Për.....67

Kundër.....2

Abstenim.....0

Me 67 vota për dhe 2 kundër aprovohet Projektligji për Bletarinë,

Ju faleminderit, dhe me kaq seanca sot përfundoi

Seanca përfundoi në orën 14,30 minuta.

Pjesë përbërëse e transkriptit është inçizimi elektronik.

